

VIOLETA MJTOVSKA

OLJVERA VELJÇKOVSKA

VESNA GAVRJLOVSKA – AVRAMOVSKA

# SHOQËRIA

PËR KLASËN E PESTË

PËR ARSJMËN FJLLOR NËNTËVJEÇAR

***Në bazë të vendimit nr. 224617/1 të datës 19.08.2010 të Komisionit nacional për tekste, vlerësim profesional të dorëshkrimit bëri ekipi vijues i recensentëve:***

Prof. dr. Vllado Timovski  
Prof dr. Biljana Kamçevska  
Mr.Gordana Pletvarska – Trajçevska  
Mr. Skender Asani  
Mr. Bllagica Stankovska

***Lektor i botimit në maqedonisht::***

Dr. Veselinka Llabroska

***Bashkëpunëtorë:***

Biljana Kërtolica  
Anastasija Stojanovska

***Përkthyes:***

Xhevrije Zekiri

***Redaktim profesional:***

Prof. dr. Agim Poloska

***Lektor i botimit në shqip:***

Rolland Poloska

***Botues:***

Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë

***Shtyp:***

Qendra grafike shpkp, Shkup

***Tirazhi:***

8.000

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 19-6285/1 të datës 27.08.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска библиотека  
“Св.Климент Охридски”, Скопје  
373.3.016:316.3(075.2)=163.3  
МИТОВСКА, Виолета  
Општество за петто одделение за деветгодишно основно образование / Виолета  
Митовска, Оливера Величковска, Весна Гавриловска-Аврамовска. - Скопје :  
Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010 . - 128 стр.  
: илустр. во боја ; 28 см  
ISBN 978-608-228-001-3  
1. Величковска, Оливера [автор] 2.Гавриловска-Аврамовска, Весна [автор]  
COBISS.MK-ID 84084490

# NXËNËS I NDERUAR

## **Sa e njeh vendin tënd si pjesë e botës?**

Ky libër do të jetë udhëzuesi yt, i cili do të të njoftojë dhe do t'i pasurojë njohuritë tuaja për **Republikën e Maqedonisë**, për karakteristikat e saja, për të kaluarën e saj, për trashëgiminë kulturore, si dhe për Unionin Evropian dhe institucionet e tij. Do t'i njoftosh të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e fëmijëve, por edhe të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Do ta njoftosh **vetveten si përsone dhe si pjesë i grupit**. Do të njohësh shumë gjëra për botën dhe për problemet aktuale botërore. Libri dhe hulumtimet e shumta, teknikat e të mësuarit, projektet dhe detyrat punuese do të orientojnë prej nga t'i fitosh njohuritë dhe si t'i zgjerosh ato.

Plotësoji njohuritë e gjertanishme! Zgjeroji njohuritë tuaja.

Respektoji rregullat e punës , degjo, hulumto, diskuto, analizo, mbikqyr, argumento...

Autorët

## NJOFTOHU ME LIBRIN

1. Tema : ATDHEU YNË REPUBLIKA E MAQEDONISË
2. Tema: PERSONALITETE NË GRUPIN DHE NË SHOQËRI
3. Tema: REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BOTË

Figura si shokët tuaj do t'ju udhëzojnë në libër:



**Hulumto!**

**Krahasoji përfundimet tuaja me tonat!**



**Detyrë?**

**Diskutim; Debat**



**Të rikujtohem!**



**Diçka më tepër!**

**Ç'mësova?**



# ATDHEU YNË REPUBLIKA E MAQEDONISË

## DO TË BJSEDOJMË PËR:

- bukuritë në vendin tonë
- Pozita e Republikës së Maqedonisë dhe fqinjët e saj;
- historia dhe e kaluara e saj;
- kryeqyteti;
- pse është e rëndësishme që një vend të jetë demokratik?

## DO TË MËSOJMË PËR:

- Maqedonia si pjesë e Evropës dhe Ballkani
- Shkupin – kryeqytet i Republikës së Maqedonisë;
- Shteti, institucionet shtetërore;
- periodizimi i së kaluarës maqedonase;
- Ekonomia në R.e Maqedonisë;
- turizmin në Maqedoni;
- të drejtat dhe obligimet e qytetarëve;
- jeta kulturore në shtetin tënd
- popullsia dhe struktura e popullsisë;




## DETYRA JOTE DO TË JETË:


- të hulumtosh për pasuritë dhe bukuritë e vendit tënd si dhe të vendeve fqinje;
- të përgatisësh album dhe raport për qytetin e Shkupit dhe karakteristikat sociodemografike;
- përmes teknikës - kalavesh t'i paraqesësh karakteristikat natyrore të Maqedonisë;
- të përgatisësh projekt për të kaluarën e Maqedonisë;
- të përpunosh hartë turistike të R. së Maqedonisë;
- të përgatisësh T-tabelë me të drejtat dhe obligimet e qytetarëve në vendin tënd



# HARTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



## ATDHEU YNË REPUBLIKA E MAQEDONISË



Që më mirë të njihesh me vendin tënd,  
që t'i pasurosh njohuritë tuaja, shfrytëzo  
enciklopedi, libra, fotografi, videoinçizime  
Të nevojshme do të jenë edhe hartat  
gjeografike të: Republikës së Maqedonisë,  
Gadishullit Ballkanik, Europës....  
Vizito bibliotekën, shfrytëzo internetin!!!  
**Stuhi idesh: nocion atdheu**

Atdheu- ti je ai, dhe unë  
ajam ai, të gjithë ne!  
Ai është diell i madh që  
rreh në zemrat tona

**Vidoe Podgorec**

Atdheu është trashigimi, në të njëjtën kohë posedimi i vendit, territorit, vlerave shpirtërore dhe përmbajtjeve, të cilat e përbëjnë kulturën e një vendi.

**Republika e Maqedonisë është atdheu ynë.**

**Republika** paraqet formë të rregullimit shtetëror. Në republikën populli e zgjedh pushtetin në zgjedhje demokratike për disa vite të caktuara. Kryetari i Republikës, gjithashtu, është i zgjedhur nga populli.



**Shteti** është përmbledhje institucionesh sipas të cilave sillen njerëzit.

Republika e Maqedonisë është shtet demokratik i pavarur.

### Harta e Republikës së Maqedonisë

Maqedonia është vend të cilën e zbukurojnë shumë bukuri natyrore. Është e pasur më: pyje, livadhe, fusha pjellore, liqenj dhe lumenj, shpella, ujëvare, monumente kulturore-historike... Është e pasur me botë bimore dhe shtazore të ndryshme. Ajo është djep i diturisë ku krijojnë dijetarë të njohur.

**Hulumto, gjurmo dhe kupto më shumë karakteristika për atdheun tënd.**

## Maqedonia dhe fqinjët e saj



Hulumtoni me ndihmën e hartës gjeografike!  
Gjejini shtetet fqinjë dhe kryeqytetet e tyre.  
Përcaktoni cili shtet në cilën anë kufizohet me Maqedoninë!  
Në cilat shtete ka pjesë të liqeneve tanë natyrorë?  
Mësoni disa karakteristika të shteteve fqinjë të Republikës së Maqedonisë!  
(madhësi, reliev..)

**Shtetet fqinje të Republikës së Maqedonisë janë:** Republika e Serbisë, Republika e Kosovës, Republika e Bullgarisë, Republika e Greqisë dhe Republika e Shqipërisë.



**HARTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE FQINJËVE TË SAJ**



**Flamujt e shteteve fqinje**





Republika e Maqedonisë në **veri** kufizohet me **Republikën e Serbisë**, me kryeqytetin e saj Beogradin. Republika e Serbisë nuk ka dalje në det. Relievi në Serbi është i llojllojshëm. Klima kryesisht është mesatare-kontinentale.

Atdheu ynë në **jug** kufizohet me **Republikën e Greqisë**. Kryeqyteti është Athina. Greqia është shtet ishullor dhe gadishullor. Është anëtare e Unionit Evropian. Ka dalje në Detin Egje, Detin Jon dhe Detin Mesdhe. Relievi në Greqi është kryesisht malor. Klima është mesdhetare dhe malore.

Republika e Maqedonisë në **lindje** kufizohet me **Republikën e Bullgarisë**, me kryeqytetin Sofja. Bullgaria është anëtare e Unionit Evropian. Nëpër Bullgari kalon njëri nga koridoret më të rëndësishme në Gadishullin Ballkanik. Bullgaria ka dalje në Detin e Zi. Klima është bregdetare, mesatare-kontinentale dhe malore. Pjesa më e madhe e relievit është malor.

Maqedonia në **perëndim** kufizohet me **Republikën e Shqipërisë**, me kryeqytetin Tirana. Shqipëria është vend ballkanik dhe mesdhetar. Ka dalje në Detin Adriatik dhe në Detin Jon. Klima në Republikën e Shqipërisë është mesdhetare dhe mesatare-kontinentale. Relievi kryesisht është malor.

Në **veriperëndim** kufizohet me **Republikën e Kosovës** me kryeqytetin Prishtina. Relievi i Republikës së Kosovës është i llojllojshëm. Klima është kontinentale me vera të ngrohta dhe dimra të ftohtë dhe me borë.

### Hulumto!

Me ndihmën e hartave gjeografike, internetin dhe të dhënat e tjera mëso më shumë për relievin e shtetëve fqinj.



## ÇFARË KEMI MËSUAR?



1. Përshkruaji karakteristikat e Republikës së Maqedonisë si shtet!
2. Sqaroje nocionin atdhe!
3. Çfarë paraqet republika?
4. Çfarë shtet është Republika e Maqedonisë? Pse?
5. Me cilat shtete kufizohet Republika e Maqedonisë?
6. Bëj krahasim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe fqinjët e saj dhe shqyrtoji ndryshimet!

## SIMBOLET SHETËRORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Bisedo më shokët dhe prindërit; kërkoni ndihmë në internet dhe në enciklopedi.

Shikojini simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë dhe hulumto cilat janë karakteristikat e saja! Çfarë simbolizojnë ngjyrat e flamurit?



Simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë janë: **stema, flamuri dhe himni.**



**Flamuri i Republikës së Maqedonisë**

**Flamuri** i Republikës së Maqedonisë është i kuq. Nga mesi i saj, deri në skaje të flamurit, është i shpërndarë dielli me tetë rrezet e saja.

Flamuri shtetëror valon në të gjitha institucionet shtetërore, në rrugë gjatë festave shtetërore, në manifestime kulturore dhe sportive, për pritjen e mysafirëve të posaçëm nga vendi dhe jashtë...

Kur flamuri shtetëror është në gjysmë të shtizës, atëherë në shtet është shpallur ditë zije.

### Stema e Republikës së Maqedonisë

**Stema** e Republikës së Maqedonisë është fushë e ndërtuar me afion, duhan dhe grurë. Në mes gjenden majat e maleve tona, ndërsa uji i përfaqëson lumenjtë dhe liqenet.

Stema është në përdorim që nga 27 korrik të vitit 1946, ndërsa në 16 nëntor të vitit 2009 mënjanohet ylli i kuq.



## SOT NË MAQEDONI LINDET

Sot në Maqedoni lindet  
dielli i ri i lirisë.  
maqedonasit luftojnë  
për të drejtat e tyre.

Përsëri tani flamuri valon  
në Republikën e Krushevës.  
Goce Dellçev, Pitu Guli,  
Dame Gruev, Sandanski.

Malet maqedonase zëshëm  
këndojnë  
këngë luftarake, lajmëtarë të ri  
Maqedonia e lirë  
në liri jeton

### Himni i Republikës së Maqedonisë



**Himni** paraqet këngë solemne për secilin shtet. Me himnin tonë tregohet e kaluara dhe e ardhmja.

Himni këndohet në manifestime, për festat shtetërore, ndeshje sportive, për pritjen e mysafirëve të jashtëm.

Gjatë të kënduarit të himnit për respekt ndaj tij dhe ndaj shtetit që e përfaqëson, duhet të gjithë të ngrihen në këmbë.

### ÇFARË KEMI MËSUAR?

1. Numëroji dhe sqaroji simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë!
2. Kur shpallet flamuri?
3. Kur këndohet himni?



Në orën e arsimit figurativ vizatojini flamurin dhe stemën e Republikës së Maqedonisë, duke përdorur teknika dhe materiale figurative!  
Në orën e arsimit figurativ dëgjoheni dhe mësojeni himnin e Republikës së Maqedonisë!

## SHKUPI – KRYEQYTET I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shikoni me kujdes hartën e Republikës së Maqedonisë dhe përcaktoni pozitën e kryeqytetit!

Formoni grupe dhe ndani aktivitetet ndërmjet veti, hulumtoni dhe mësoni sa më shumë të dhëna për Shkupin si kryeqytet i Republikës së Maqedonisë: të dhëna gjeografike, qendra ekonomike, qendra administrative-politike, qendra shkencore-arsimore dhe kulturore dhe lokacione turistike

Shfrytëzoni burime të ndryshme të informacioneve (libra, enciklopedi, revista, internet...)


Prezantoni para klasës!

Mos harroni të grumbulloni fotografi dhe kartolina!



**Kryeqyteti i Republikës së Maqedonisë** gjendet në veri të vendit tonë, në luginën e Shkupit. Shkupi gjendet në anën e majtë dhe në anën e djathtë të lumit Vardar, ku është e ndërtuar dhe Ura e Gurrit, që është dhe simbol i qytetit. Mbi të gjendet kalaja Kale. Shumë interesante është dhe çarshija e vjetër e Shkupit në të cilën ka shumë zanatçinj.

Shkupi është kryeqytet, **metropol** i Republikës së Maqedonisë. Këtu gjenden institucionet më të rëndësishme shtetërore: Qeveria, Parlamenti, Gjyqi Suprem dhe Kushtetutës.



Stema e qytetit të Shkupit

Shkupi sot



Flamuri i qytetit të Shkupit

Qyteti ka një të kaluar të gjatë. Ka mbijetuar shumë luftëra, sëmundje, tërmete.....

Çdoherë ai rindërtohet. Për Shkupin thuhet së është qytet i solidaritetit. Në vitin 1963 një tërmet i tmërshtëm e ka rrënuar, mirëpo me ndihmën e njerëzve nga gjithë bota përsëri është rindërtuar.



Shkupi në shek. XVII



Shkupi pas tërmetit

Sot Shkupi është qytet modern me ndërtesa të vjetra dhe moderne, me parqe, vendparkime. Ka një industri të zhvilluar, ekonominë, turizmin... Ka më shumë qendra kulturore (teatra, opera, kinema, biblioteka, muze, monumente historike...), qendra edukative (fakultete, shkolla, çerdhe...) dhe objekte fetare.

**Shkupi është qendër politike, kulturore, industriale, tregtare e Republikës së Maqedonisë.**

Me teknikën “**pasqyra skeletore**” prezantoje qytetin e Shkupit gjatë kohës (nga themelimi i tij deri sot).

## Ç’ KEMI MËSUAR?

1. Përshkruaji karakteristikat e kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë.
2. Cilat janë funksionet ekonomike, politike dhe kulturore të kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë?

**Ndajuni në grupe** sipas asaj se çka keni vizituar ose çfarë materiali keni. Arsimtari i përcakton grupet. Çdo grup le të shkruajë raport për atë se çka keni parë dhe çfarë përshtypje keni fituar. Nga raportet, fotografitë, dhe tekstet e realizuara bëni album klasor.

# VENDPOZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**Botën** e përbëjnë sipërfaqe të mëdha tokësore të ashtuquajtura kontinente. Ato shtrihen në rruzullin tokësor.

## Aktivitete hulumtuese!

Cilat janë kontinentet e rruzullit tokësor?  
Përcaktoje pozitën e Republikës së Maqedonisë me ndihmën e globit ose hartës gjeografike të botës!  
Me cilat shtete evropiane është e lidhur Republika e Maqedonisë?



**Territori shtetëror** përfshin çdo gjë që është në suaza të kufijve të një shteti duke përfshirë tokën, ujrat dhe hapsirën ajrore, me të gjitha pasuritë natyrore.



Republika e Maqedonisë është vend **evropian**. Gjendet në pjesën juglindore të kontinentit të Evropës, në pjesën e **mesme** të Gadishullit Ballkanik.

Gadishulli Ballkanik ka një pozitë të volitshme, për shkak se lidh tre kontinente. Me linjën ajrore është e lidhur me të gjitha kontinentet. Ndër të tjera më i rëndësishëm është autostrada E-75 dhe hekurudha Shkup – Gjevgjeli.

## Harta e Evropës

Republika e Maqedonisë si shtet Ballkanik, gjithashtu, ka pozitë të volitshme. Ajo paraqet udhëkryq i rrugëve më të rëndësishme i cili na lidh me shtetet ballkanike.

**Maqedonia nuk ka dalje në det. Prandaj ajo është vend kontinental. Megjithatë ka një pozitë të volitshme gjeografike.** Nëpërmjet linjave rrugore, ajrore, hekurudhore është e lidhur me shumë shtete të Evropës dhe kontinente.



## Vendpozita e Republikës së Maqedonisë në Gadishullin Ballkanik

Republikën e Maqedonisë e karakterizojnë shumë bukuri natyrore.

Kërko tekste dhe fotografi për bukuritë natyrore të vendit tonë.  
Nëpërmjet teknikës kalavesh prezantoji bukuritë natyrore të Republikës së Maqedonisë!  
Bisedo, hulumto!  
Shikoje hartën e Republikës së Maqedonisë dhe gjeji bukuritë natyrore të vendit tonë!



Shënim i Republikës së Maqedonisë me rrëqebull, troftë, ngjalë molikë (lloj pishe)...




## ARTIKUJ INTERESANTE

Parku kombëtar **Pelister** është më i vjetër në vendin tonë. Është karakteristik për bimët endeme dhe kafshët e rralla si **rrëqebulla**, arusha, dreri dhe deri i egër.

**Trofta** është peshk endem i ujrave të ëmbla, jeton në Liqenin e Ohrit.

**Ngjala** jeton në ujrat e Liqenit të Ohrit.



**Relievi** i Republikës së Maqedonisë është kodrinor-malor. E përbëjnë tre pjesë:

- ❖ Pjesa perëndimore, e cila karakterizohet me male të larta, dhe në mes tyre gjenden lugina të thella;
- ❖ Pjesa e mesme, në të cilat gjenden lugina, të cilat disa prej tyre janë të lidhura me gryka;
- ❖ Pjesa jugore, e cila është më e ulët se pjesa perëndimore dhe i përfshin pjesët e lumit Vardar.

Në Maqedoni mbizotëron **klimë e mesme kontinentale**, të cilën e karakterizojnë vera të thata dhe të ngrohta si dhe dimra të ftohtë dhe me lagështirë.

**Ujërat**, (lumenjtë dhe liqenet), janë pasuri të mëdha natyrore të Republikës së Maqedonisë. Në të gjithë Republikën e Maqedonisë ka burime minerale, të cilat shërbejnë për shërime dhe ngrohje të oranzherive.

Lumi më i gjatë është **Vardari**, me 338 kilometra dhe më shumë rrejdh në pjesën qendrore të shtetit. Buron në rrëzën e Malit Shar, nga burim i fortë te fshati Vrutok dhe derdhet në Detin Egje.

Limi **Drini i Zi** rrjedh nga Liqeni i Ohrit. Radika dega e lumit Drini i Zi është një ndër lumejtë më të bukur, më të pastërt, më piktoresk në Maqedoni.



Në kufirin jugor të Republikës së Maqedonisë shtrihen tre **liqene natyrore**:

**Liqeni i Ohrid** është liqeni më i madh natyror në Republikën e Maqedonisë. Ai është një ndër liqenet më të thella dhe me dukshmëri më të madhe në Evropë. Për shkak të gjirit, ishujt të shumtë, bukuritë të maleve të rrethit dhe ekzistimi i mbi 140 lloje të kafshëve endeme, Liqeni i Ohrit ka hyrë në listën e bukurive të rralla natyrore të UNESCO-s

I dyti për nga madhësia në Republikën e Maqedonisë është **Liqeni i Prespës**. Ai karakterizohet me degëzimin e gjirëve, gadishujve, plazheve me rërë dhe një ishull i vogël, i cili quhet **Golem Grad**.

Liqeni më i vogël natyror është **Liqeni i Dojranit**. Është i pasur me botë të gjallë, veçanërisht me peshk, ndërsa përmes bregut ka brez të madh të kallamit.



Me rindërtimin e luginave lumore njeriu ka ndërtuar **liqene artificiale**. Ato shfrytëzohen për ujëtimin e tokave pjellore, për prodhimin e energjisë elektrike, për sigurimin e ujit të pijshëm, për turizëm, sport dhe rekreacion.

<b>Liqene</b> <b>Natyrore:</b> Liqeni i Ohrid, Prespës dhe Dojranit <b>Artificialë:</b> Liqeni i Dibrës, Mavrovës, Kalimancit, Tikveshit..	<b>Banja:</b> Banjat e Dibrës, Katllanovës, Banskos, Kosovrastit...
<b>Fusha:</b> e Pellagonisë, e Pollogut, Gjevgjeli-së-Vallandovës Strumicës, Ovçe Poles, Luginës së Shkupit	<b>Lumej:</b> Vardari, Lumi i Zi, Radika...
	<b>Male:</b> Malet e Sharrit, Korabi, Kozhufi, Malet e Osogovës, Bellasica, Ograzhdeni, Karadaku i Shkupit

## ÇFARË KEMI MËSUAR?

1. Pse Republika e Maqedonisë ka pozitë të volitshme?
2. Cilat janë karakteristikat e Republikës së Maqedonisë?
3. Numëroji ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet liqeneve natyrorë?

## Hulumtoni,

Dhe pastaj punoni pasqyrë tabelare në të cilin do t'i prezantoni:

- lartësinë e maleve në Republikën e Maqedonisë;
- gjatësinë e lumennjve.
- cilave shtete fqinjë u takojnë pjesë të liqeneve natyrorë.

## PERIODIZIMI I SË KALUARËS TË MAQEDONISË

Kërkoni materiale për të kaluarën e largët të vendbanimit tënd dhe të Republikës së Maqedonisë (enciklopedi, fotografi, filma, internet...)

**Përpunoni projekte** për periudha të ndryshme kohore.

Zgjeroni me ngjarje nga **vendi juaj!**

**Vizitoni** lokalitete arkeologjike, monumente kulturore-historike...



Në shek. VIII para erës së re ka filluar me bashkimin e fiseve maqedonase në një shtet të vetëm. Në krye të shtetit ka qendruar mbreti. Për themelues të shtetit maqedonas llogaritet mbreti Perdika. Trashigimtarët e Perdikës kanë tentuar që ta forcojnë dhe zgjerojnë shtrirjen e shtetit. Ekspanzion më të madhë shteti maqedonas ka pasur në kohën kur kanë sunduar mbretërit **Filipi i II dhe Aleksandri i III**. Atëherë Maqedonia është ngritur në shtet të fuqishëm botëror – “Zotëreshë e botës”, siç e kanë quajtur autorët e antikës. Me ardhjen dhe shpërnguljen e fiseve maqedonase në shek. VI dhe më përzierjen e tyre banorët maqedonas antikë, më në fund në shek. X dhe XI bëhet formimi i popullit modern maqedonas, i cili deri më sot është shumicë në territorin e Maqedonisë.



**Aleksandri i Maqedonise**



**Monedha nga koha e Aleksandrit**

**Perandoria** është rregullim shtetëror monarkik në krye të së cilës është perandori. Secili perandor e trashëgon fronin nga i ati. Perandoria është më e madhe së mbretëria, përfshin territor më të madh.

**Imperia** është perandori – shteti që mban nën pushtet vende dhe pasuri të huaja.


Qytetin Aleksandria e ka themeluar Aleksandri dhe është quajtur sipas themeluesit.

Kali i Aleksandrit është quajtur Bukefall.



## Maqedonia në shekullin e mesëm

Përdori njohuritë e tua nga aktivitetet hulumtuese përmes stuhinë e ideve. Përpuno tabelë: **ndonjëherë dhe tani**.



Nga fundi i shekullit VI dhe fillimi i shekullit VII në territorin e Maqedonisë kanë ardhur sllavët. Paraatdheu i tyre ka qenë pas Karpateve, mirëpo për shkaqet e këqia të jetesës, si edhe sulmet nga fqinjët, ata filluan të shpërngulen.


Duke kërkuar kushte më të mira për jetesë janë drejtuar në tri drejtime: në lindje, në perëndim dhe në jug. Ata, të cilët u nisën për në jug, quhen sllavë të jugut.

Në atdheun e tyre **sllavët** nuk kanë pasur shkrim, një kohë të gjatë me vija dhe vijëza “lexonin dhe hidhnin fall”. Kur kanë ardhur në Ballkan dhe janë krishterizuar, fjalët sllave i kanë shkruajtur me shkronja romake dhe greke, pa rregulla. Me shkrim të tillë nuk ka qenë e mundur të shkruhen shumë fjalë sllave. Në alfabetin grek nuk ka pasur shkronja për shumë tinguj sllavë. “Më pas shën Konstantin-Qiril ka krijuar 38 shkronja, disa sipas shkronjave greke, të tjerat sipas nevojës së gjuhës sllave”.

Vëllezërit Qiril dhe Metodij kanë qenë shumë të ditur. Ata e kanë krijuar alfabetin e parë sllav – **glagolicën**, ndërsa nxënësit e tyre Klimenti dhe Naumi e kanë falur dhe shkrimin e ri e kanë quajtur **kirilicë**. Me krijimin dhe zgjerimin e shkrimit dhe letërsisë sllave Maqedonia ka dhënë kontribut në kulturën botërore.



Shën Qirili dhe Metodij



Shën Klimenti



Shën Naumi

Shkruaj hartim në formë të raportit për rëndësinë e shën. Qirilit dhe Metodit.

Në mesin e shekullit X ka qenë i krijuar shteti mesjatar maqedonas. Në krye të shtetit ka qenë Car Samoili. Ai ka pasur ushtri të fuqishme. Me luftërat fituese, që i ka udhëhequr, e ka zgjeruar shtetin në veri deri te Dunabi dhe Sava, në jug deri në Thesali, në perëndim deri te Deti Adriatik dhe në lindje deri te Deti i Zi.

Në luftë në Belasicë (viti 1014), me Bizantin, car Samoili ka pësuar disfatë, ndërsa 14000 ushtarët e tij i kanë verbuar. Pas asaj ndodhie car Samoili ka ndërruar jetë. Shteti mesjatar maqedonas ka ekzistuar deri në vitin 1018, kur është përfshirë në kuadër të shtetit Bizantin.



**Ushtria e Samolit**



**Car Samoili**



Gjej dhe lexo ndonjë tregim ose libër për shtetin e parë maqedonas dhe për car Samoilin.



### **Maqedonia gjatë sundimit otoman**

Në fund të shek. XIV Maqedonia ka qenë e sunduar nga turqit – osmanllinjë dhe është futur në përbërjen e Imperisë otomane. Populli maqedonas shpesh është ngritur në kryengritje. Forma më e vjetër e armatosur e rezistencës ka qenë hajdutëria.

Kryengritja e madhe e parë në Maqedoni ka ndodhur në vitin 1689 nën udhëheqjen e Karposhit.

Në format e rezistencës kundër Imperisë otomane ka marrë pjesë edhe biskupi shkupjan Pjeter Bogdani.

Lëvizja e çlirimit në Maqedoni është përforcuar në shek. XIX. Atëherë kanë ndodhur më shumë kryengritje (e Negushit, e Razllovecit dhe e Kresnenit).



**Jane Sandanski me çetën e tij**



**Fshati maqedonas në kohën e sundimit otoman**

Nga të gjitha kryengritjet dhe rebelimet, kryengritja më e rëndësishme është **Kryengritja e Ilindenit**, që ka filluar në 2 gusht të vitit 1903. Në luftën për liri, përkrah maqedonasve, kanë marrë pjesë edhe vllahët, shqipëtarët dhe turqit).



Goce Dellçevi



Nikolla Karevi



Gjorçe Petrovi



Dame Gruevi



Pitu Guli

Revolucioner të njohur të asaj kohe janë: **Goce Dellçev, Pitu Guli, Jane Sandanski, Dame Gruev, Gjorçe Petrov, Pere Toshev etj.**

Në Krushevën e liruuar është formuar Republika e Krushevës. Është formuar Këshill i Republikës, të cilin e përmbënin 60 qytetarë dhe qeveri e përkohshme prej 6 anëtarësh. Në krye të Qeverisë ka qenë Vangjell Dinu, kurse kryetar i Republikës ka qenë **Nikolla Karev**.

**Republika e Krushevës ka mbijetuar vetëm dhjetë ditë.**

**Ilindenit ka rëndësi të veçantë në historinë e shtetit maqedonas.**

Gjatë Perandorisë otomane, përveç tatimeve të tjera, ka ekzistuar edhe **tatim me gjak**. Ajo ka paraqitur marrje me dhunë të fëmijëve mashkullorë nga prindërit. Fëmijët i shpinin në Turqi, i edukonin dhe i mësonin të bëhen ushtarë mizorë. Luftëtarët e këtillë janë quajtur **janiçarë**.



Në mbrojtjen e Krushevës kryengritësit kanë përdorur **top**. Detyra jote është të zbulosh nga cili material është përpunuar?



**Topi i Krushevës prej qershie**

**Unë jam gazetar hulumtues!**

**Paramendo** se je gazetar. Mendo dhe shkruaj **lajm** për Krushevën-qytet i pasur me ngjarje dhe persona.



## Luftërat ballkanike dhe lufta e parë botërore

Barë të madh dhe numër të madh viktimash në luftërat ballkanike ka pësuar populli maqedonas (1912-1913).

**Lufta e Parë ballkanike** është zhvilluar ndërmjet Imperisë otomane dhe Lidhjes ballkanike të përbërë prej Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Në luftën kanë marrë pjesë edhe maqedonasit, në mënyrë të pavarur ose në përbërje me lidhjet ballkanike. Ata kanë shpresuar se do të lirohen nga pushteti turk dhe se do të formojnë shtetin e tyre. Por, pritjet e tyre nuk u realizuan. Maqedonia ka qenë e okupuar dhe e ndarë ndërmjet Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë.

**Lufta e Dytë ballkanike** ka filluar në qershor të vitit 1913, kur Bullgaria, e pakënaqur nga ndarja territoriale, i ka sulmuar aleatët e saj Serbinë dhe Greqinë. Lufta e Dytë ballkanike mbaron me **marrëveshjen e Bukureshtit**. Me këtë marrëveshje është vërtetuar ndarja e Maqedonisë.

Pas luftërave ballkanike, në vitin 1914 ka filluar **Lufta e Parë botërore**, e cila ka zgjatur katër vjet.

Në luftën e parë botërore populli maqedonas ka qenë i ekspozuar në okupime, shkatërrime luftarake dhe ndarje të reja.



Viktima nga Lufta e parë botërore

## ÇFARË KEMI MËSUAR?



**Sqaro** sipas cilët banorë të lashtë Maqedonia e ka fituar emrin.

**Përkufizoje** rëndësinë e Lekës së Madh.

**Bëj një** shqyrtim për ardhjen e sllavëve të vjetër dhe formimin e shtetit të parë.

**Përshkruaje** luftën në malin e Bellasicës.

**Përcaktoje kohën** kur Maqedonia ka rënë nën pushtetin Otoman.

**Përshkruaj** çfarë di për Kryengritjen e Ilindenit dhe për Kryengritjen e Krushevës!

**Sqaro** kur është e ndarë Maqedonia dhe nga kush.




## FORMIMI I SHTETIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS

### Maqedonia në Luftën e Dytë botërore

Shteti bashkëkohor maqedonas është krijuar gjatë luftës katërvjeçare antifashiste dhe nacionalçlirimtare (1941-1944). Lufta e Dytë botërore për Maqedoninë ka qenë ndarje e re e territorit kombëtar, asimilimit kombëtar dhe eksploatimit ekonomik. Duke qëndruar në anën e koalicionit antifashist, populli maqedonas është nisur në luftë të armatosur për realizimin e idealeve dhe të aspiratave shekullore – lirim dhe krijim të shtetit të tyre kombëtar.



Stacioni bullgar policor në Prilep – objekt nga akcionet e para të partizanëve maqedonas, me skicë të sulmit – 11 tetorë 1941



Salla në të cilën është mbajtur mbledhja e parë e ASNOM-it

Rezistenca antifashiste ka qenë e organizuar nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (PKJ) në krye me Jusip Broz Tito, respektivisht të Partisë Komuniste të Maqedonisë (PKM).

Lufta për çlirim në Maqedoni ka filluar më **11 Tetor të vitit 1941**. Atëherë janë shtënë pushkat e parë në Prilep dhe Kumanovë.

Për këtë arsye **11 Tetori festohet si festë e kryengritjes së popullit maqedonas**.

Nga këto qytete lufta është transferuar në gjithë vendin. Luftën e kanë udhëhequr partizanët. Në luftën Maqedonia ka dhënë shumë viktima mes të cilëve janë edhe heronjtë kombëtarë: **Strasho Pinxhur, Ibe Palikuqa, Mirçe Acev, Cvetan Dimov, Kuzman Josifovski-Pitu, Vera Ciriviri – Trena, Liman Kaba, Bajram Shabani** etj.

Në 2 gusht të vitit 1944 në manastirin **Prohor Pçinski** është e mbajtur mbledhja e parë e ASNOMIT. Në këtë mbledhje janë sjellë shumë vendime, me të cilat është deklaruar krijimi i shtetit maqedonas dhe janë miratuar organet e saja më të larta. Kryetar i parë është zgjedhur Metodija Antonov – Çento.

Për Maqedonin ASNOM ka rëndësi tepër të madhe: **Maqedonia është deklaruar si shtet; gjuha maqedone është e pranuar si gjuhë zyrtare, qytetarët të cilët jetojnë në Maqedoni, pa dallim religjioni, kombi apo gjinie janë qytetarë të barabartë...**

### Nëse dëshiron të mësoh më tepër!

Më 16 prill të vitit 1945 është formuar Qeveria e parë e Maqedonisë. Në të janë përfshirë edhe anëtarë të bashkësive në Maqedoni, siç ka qenë Nexhat Agolli, ministër për politikë sociale.



Detyrë: hulumtoni, fitoni informacione për pjesëmarrësit në luftën tonë për liri gjatë Luftës së Dytë botërore.



## KRYETARI I PARË I MAQEDONISË



**Metodija Andonov-Çento** (1902-1957), politikan dhe patriot. Ka qenë kryetar i Bordit iniciativ për thirrjen e ASNOM-it (1943), kryetar i Prezidiumit të ASNOM-it. Luftëtar i paluhatshëm për çlirimin kombëtar të popullit maqedonas dhe për Maqedoninë të pavarur dhe të bashkuar.





**Pas luftës së dytë botërore** Maqedonia është në përbërje të Federatës së Jugosllavisë (RSFJ) si Republikë e barabartë.

Kërko foto dhe shkrime nga koha e ndërtimit të shtetit tonë pas Luftës së dytë botërore. Përdore edhe internetin!

Mëso ç'është ndërtuar dhe formuar në Republikën e Maqedonisë.

Nëse ke ndonjë të afërm që ka marr pjesë në aksionet punuese le të të rëfejë.

Të gjitha të dhënat që do t'i mësosh si edhe materialin e mbledhur, rregulloji bashkë me shokun ose në grupe, ndërsa më vonë ndaji me të tjerit në klasë.



**Aksioni punues rinor**

Pas luftës Maqedonia është e shkatërruar dhe vend i pazhvilluar. Pasuritë natyrore dhe pjesëmarrja e popullit në ndërtimin dhe rinovimin e shtetit sjellin zhvillim të shpejtë ekonomik.

Maqedonia ndërtohet dhe përparon, bëhet eletrifikim në fshatrat, ndërtohen rrugë moderne, hekurudha, fabrika, hidrocentarle, institucione shëndetësore, kulturore dhe arsimore.

Nga materialet e gjetura, shkrimet, nga tregimet, nga fotot dhe materiale të tjera përpuno pano.

Procedura hulumtuese në temë:

**“Kujtime për Referendumin e 8 Shtatori të vitit 1991”**

Çfarë do të thotë fjala **sovrانيتet**?

Përpiqu ta sqarosh fjalën **referendum**.



Qytetarët e shtetit tonë në **8 shtator të vitit 1991**, në Referendum u deklaruan për **Republikën e Maqedonisë së pavarur dhe sovrane**.

Në këtë ditë çdo vit solemnisht shënohet dhe festohet pavarësia e Republikës së Maqedonisë. **Tetë shtatori është festë shtetërore e Republikës së Maqedonisë!**

Më 17.XI. të vitit 1991 Parlamenti i Republikës së Maqedonisë e miratoi **Kushtetutën** e parë të Maqedonisë së pavarur dhe sovrane. Kushtetuta është akti më i lartë në një shtet.

Si shtet i pavarur, më 8 prill të vitit 1993, Maqedonia është pranuar si **anëtare e barabartë në OKB** (Organizata e Kombeve të Bashkuara).

Ngarje e rëndësishme për popullin maqedonas është edhe **liberalizimi i vizave** me të cilin qytetarëve tanë u mundësohet të udhëtojnë në shtetet e Unionit Evropian pa viza.

**Sovranitet** – sjelljen e vendimeve në mënyrë të pavarur në punët e brendshme të shtetit dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera.

**Referendum**- paraqet deklaram demokratik të qytetarëve për çështje të caktuar e të rëndësishme për shtetin.



Vendvotimi



Mbledhje për shpalljen e pavarësisë së shtetit tonë si shtet të pavarur në vitin 1991.

Në orën e mësimt të gjuhës maqedonase bëni punim në temë:  
“Si ishte formuar shteti im”

## PROJEKTI MËSIMOR

Me mësuesin tuaj përgatituni për projekt mësimor!  
Përpunoni projekt hulumtues me temë:

### “MAQEDONIA NË TË KALUARËN”

Mos e harroni rrethin e rregullave!  
Diskutoni dhe mësoni fazat e projektit!  
Shfrytëzoni njohuritë e mëparshme, përvojat, por edhe dëshirën për fitimin e njohurive të reja!

Çfarë dëshirojmë të dimë?

Të kuptojmë për historinë e Republikës së Maqedonisë!

Me prezantim në orën e mësimt!

Si do ta bëjmë këtë?

# ÇFARË KEMI MËSUAR

Sigurisht, duke grumbulluar materiale, duke degjuar në orë të mësimit dhe duke i zgjidhur detyrat në fletoret e punës, tani më ke mësuar. Këto detyra shërbejnë për të kontrolluar diturinë dhe të mësosh aty ku ke nevojë. Detyrat zgjidhen sipas përmbajtjeve, dhe jo në orë të mësimit.

Në hartë të zbrazët të RM-së: shëno, emëro, shkruaj, nënvizo, vërteto dhe përfundo:  
Me **laps të kuq** -shëno shtetet fqinje dhe kryeqytetet e tyre!  
Me **laps të kaltër** -shëno emrat e tre liqeneve natyrale!  
Me **laps të zi** -shëno kryeqytetin e vendit tënd dhe të vendbanimit (shënoji emrat e tyre)!  
Me laps të drurit nënvizojë relievin e RM-së!

Nën hartën **shëno**:

Ku gjindet Republika e Maqedonisë në Gadishullin Ballkanik, ku është Evropa, e ku është bota?




**Thekso** kur ka filluar lufta për liri në Maqedoni dhe **sqaro** çfarë paraqet ajo ditë për Maqedoninë?

Kur dhe ku është mbajtur Mbledhja e parë e ASNOM-it.

**Bëj analizë** për rëndësinë e Mbledhjes së parë të ASNOM-it.

Përdori **hulumtimet dhe bëj analizë** për kryetarin e parë të shtetit Maqedonas.

Nga materialet e grumbulluara krijoni pano. Nëse keni krijuar pano edhe nga periudhat e së kaluarës të vendit tonë, rënditi me emrin: **UDHËTIMKOHORË**.



Përpuno hartë kronologjike për të kaluarën maqedonase në periudha të veçanta. Vazhdo ashtu siç është filluar.

# RREGULLIMI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

## Aktivitetet:

Përmes teknikës “**Stuhi idesh**” mësoni më tepër për rregullimin shtetëror të Republikës së Maqedonisë!



## Çfarë shteti është Republika e Maqedonisë?

**Demokracia** është lloj i rregullimit shoqëror në të cilin qytetarët në zgjedhje publike zgjedhin përfaqësues të tyre në Parlament. Me rëndësi për një shoqëri demokratike është respektimi i të drejtave, lirive dhe obligimeve të qytetarëve.

Me **Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë** organizimi i pushtetit themelohet në parimin për ndarje në pushtet:

-Ligjdhënës

-Ekzekutiv

-Gjyqësor



**Parlamenti i Republikës së Maqedonisë**



**Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë**

Parlamenti është bartës i pushtetit ligjdhënës në Republikën e Maqedonisë për periudhë prej katër vitesh.

Parlamentin e Republikës së Maqedonisë e përbëjnë 120 (njëqind e njëzet) **deputetë** të zgjedhur nga populli.

Parlamenti e sjell Kushtetutën, sjell ligje, e zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, zgjedh gjyqtarë etj.



**Unë jam deputet në  
Parlamentin e  
Republikës së Maqedonisë!  
- lojë-**

Unë i përfaqësoj të gjithë fëmijët nga Republika e Maqedonisë dhe kërkoj...



**Lojë:** “Zgjedhni deputet nga klasa juaj”

Formoni 3 grupe! Secili grup le të propozojë përfaqësues!

Përfaqësuesit e grupeve le të shpallin argumente të tyre për çfarë do të përpiqen dhe çfarë do të bënin si deputetë! Më vonë votoni cili prej tyre do t’ju përfaqësojë.



## Qeveria e Republikës së Maqedonisë



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë** është bartëse e pushtetit ekzekutiv në shtet. Parlamenti e zgjedh Qeverinë e Republikës së Maqedonisë sipas propozimit të mandatorit i përcaktuar nga kryetari i Republikës. Qeverinë e përbëjnë kryetari i Qeverisë dhe ministrat. Qeveria i kryen Ligjet, të cilat i ka miratuar Parlamenti, dhe i propozon Parlamentit Ligje dhe dispozita të tjera, vendos për pranimin e shteteve dhe qeverive, vendos marrëdhënie diplomatike me shtete të tjera etj.

## Kryetar i Republikës së Maqedonisë

**Kryetari** i Republikës së Maqedonisë e përfaqëson Republikën në vend dhe jashtë vendit. Ai është komandant suprem i forcave të armatosura. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë parashikon zgjedhje të kryetarit të shtetit në zgjedhje të përgjithshme ose të drejtpërdrejta, me votim sekret, me mandat prej pesë vitesh.

Kryetari i shtetit doemos duhet të jetë qytetar i Republikës së Maqedonisë.

Përgatitu! Simulo lojë!

**Unë jam gjyqtar për adoleshent**



### Gjyqtari i mbron ligjet, rregullat dhe detyrat e shkruara ligjore

#### Gjyqi i Republikës së Maqedonisë



**Gjyqi Themelor- Shkup**

**Gjyqi** është bartës i pushtetit gjyqësor. Gjyqet janë institucione për mbrojtjen e Kushtetutës, Ligjet dhe të drejtat dhe obligimet e njeriut.

#### Aktivitetet:

Vizitoheni Gjyqin në vendin ku jetoni!  
Bëj intervistë me gjyqtarin!  
Mëso diçka më tepër për gjyqet dhe për punën e gjyqtarëve!  
Mblidhni të dhënat, dhe pastaj referoni në klasë.



### ÇFARË KEMI MËSUAR?

Si është rindërtuar vendi ynë pas Luftës së dytë botërore?  
Kur Maqedonia është bërë shtet i pavarur?  
Cilat ngjarje të rëndësishme kanë ndodhur nga pavarësia?  
Në çfarë mënyre qytetarët e Maqedonisë u deklaruan për shtetin sovran, demokratik dhe të pavarur?  
Cilat janë institucionet më të rëndësishme shtetërore në RM?  
Si zgjedhet kryetari i shtetit?  
Cila është detyra e gjyqeve në shtet?



# POPULLSIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



## Bëni hulumtime për:

Popullsia në ndërtesën tënde dhe në rrugën tënde sipas moshës (fëmijë, të ritur), strukturës gjinore (mashkullore, femrore) dhe të dhënat e fituara vëri në tabelë dhe analizoji!



**Popullsinë** e një shteti e përbëjnë njerëzit që jetojnë në teritorin e saj. Numri i popullsisë vërtetohet me organizimin e regjistrimit në çdo dhjetë vjet.

Numri i popullsisë në Republikën e Maqedonisë vazhdimisht ndryshon, Kjo mund të përfundohej nga të dhënat statistikore të fituara nga regjistrimi i popullsisë. Regjistrimi i fundit u realizua në vitin 2002. Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në Republikën e Maqedonisë jetojnë dy milionë banorë.

## Struktura e popullsisë

Popullsia në Maqedoni është e klasifikuar sipas:

**Strukturës gjinore;**

**Strukturës së moshës;**

**Strukturës etnike;**

**Struktura gjinore**, nënkupton raportin ndërmjet meshkujve dhe femrave në hapsirë të caktuar. Në Maqedoni mbisundon gjinia mashkullore ndaj asaj femërore.

**Kjo strukturë është komponentë e rëndësishme, prej së cilës varet rritja e popullsisë.**

**Struktura e moshës**, paraqet element demografik nga e cila shihet përfaqësimi i grupmoshave. Popullata ndahet në:


**Të rinjë – deri 19 vjeç**

**Popullatë e moshës – prej 20 – 65 vjeç**

**Të vjetër – mbi 65 vjeç**



**Struktura e moshës së popullsisë**





## Struktura etnike

Në Republikën e Maqedonisë jetojnë populli maqedonas, populli shqiptar, populli turk, populli vllah, populli serb, populli rom, populli boshnjak etj. Popuj, të tjerë që jetojnë në Maqedoni janë **bashkësi etnike**.

Çdo etnitet ka shenjat e saja, siç janë: veshjet kombëtare, doket, kulturën, religjionin etj. Të gjithë qytetarët në Republikën e Maqedonisë i kanë të drejtat e barabarta, pavarësisht nga gjinia, feja, ngjyra e lekurës, kombit, pronësisë etj.



**Veshje kombëtare maqedonase**



**Veshje kombëtare shqiptare**



**Veshje kombëtare turke**



**Veshje kombëtare rome**

Maqedonasit jetojnë edhe në shtetet fqinje si edhe në shumë shtete evropiane dhe përtejokëanike. Maqedonasit në botë e kultivojnë trashëgiminë kulturore dhe traditat.

1. Bëj raport nga hulumtimi, bëj album dhe prezantoje para klasës!



## EKONOMIA DHE VEPRIMTARITË EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Mëso se ku dhe çfarë punojnë prindërit e tu dhe të rriturit që të rrethojnë.  
Cilës degë ekonomike i takon puna e tyre.  
Bisedo për resurset natyrore në Republikën e Maqedonisë dhe për zhvillimin e ekonomisë.  
Sa janë të rëndësishme klima dhe relievi të një shteti për zhvillimin e ekonomisë?  
Sqaro fjalët: **resurse, veprimtari ekonomike** (kërko në fjalor, në enciklopedi ose nga prindri)  
Kërko fotografi dhe tekste të degëve të ndryshme ekonomike (uzina, hidrocentrale, oranzheri...)  
Vizito stacionin meteorologjik dhe bisedo me të punësuarit për klimën në Republikën e Maqedonisë dhe mundësitë për zhvillimin e ekonomisë.  
Para vete mbaj dhe hartën e Republikës së Maqedonisë.



**Ekonomia është veprimtari** e tërësishme e menduar nga njeriu ku si qëllim ka prodhimtarinë, shpërndarjen, këmbimin dhe shpenzimin e të mirave materiale në sfera të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme të zhvillimit.

Ekonomia në Republikën e Maqedonisë karakterizohet me disa periudha të zhvillimit: deri në Luftën e Dytë Botërore, pas Luftës së Dytë Botërore dhe Republika e Maqedonisë sovranë.

**Veprimtaritë ekonomike** janë ato veprimtari, që marrin pjesë në krijimin e pasurive materiale, respektivisht sendet, ushqimi, veshja, etj., dhe që janë të dedikuara për shitje.

Veprimtaritë ekonomike ndahen në primare, sekondare dhe terciare.

Në Republikën e Maqedonisë janë të përfaqësuara këto degë ekonomike:

**Veprimtari primare:** bujqësia, blegëtoria, peshkataria, gjuetia dhe bletaria.

**Veprimtari sekondare:** xehtaria, industria, energjetika, ndërtimtaria dhe zanatet.

**Veprimtari terciare:** komunikacioni, tregëtia, turizmi etj.

**Resurset** janë pasuri natyrore, të cilat ofrojnë mundësi për zhvillim.

Zhvillimi i ekonomisë së një shteti varet nga këta faktorë: **klima, bukuritë historike dhe natyrore, pasuria me ujë, malet, rafshnaltat pasuritë xeherore....**

**Vendi ynë ka kushte të volitshme për zhvillimin e disa degëve ekonomike.**




**Fabrikë për prodhimin e barnave**



**Fabrikë për përpunimin e naftës**

Secila veprimtari ekonomike i ka degët e saj.

Me kujdes shiko, mendo dhe sill përfundim se cila nga këto sfera është e pranishme në vendin tënd.



## Ndikimi i faktorëve natyrary në zhvillimin e ekonomisë



Prezantohi njohuritë që i ke fituar nga vizita në stacionin meteorologjik!  
Si është klima në vendin tënd dhe si në Republikën e Maqedonisë?  
Cilat erëra fryjnë në vendin tënd dhe cilat në Republikën e Maqedonisë?  
Çfarë thanë meteorologët për ditët e ardhshme?



### Buletini meteorologjik për sot – e enjte

**Shkup 8 C**



**Gjevgjeli 15 C**



**Berovë 4 C**



**Klima** është kusht i rëndësishëm për zhvillimin e shumë degëve ekonomike.

Në Republikën e Maqedonisë ka **klime mesatare kontinentale** – verëra të ngrohta dhe dimra të ftohtë. Klima nuk është e njëjtë në të gjitha pjesët e Republikës. Sa më afër detrave (Gjevgjeli, Dojran, Strumicë) ato vende kanë kohë më të ngrohtë.

Vendet rreth lumit Vardar kanë klimë më të ftohtë, ndërsa në hapësirat malore mbizotëron klimë malore. Temperaturat mesatare vjetore bien nga veriu në jug.

Erërat më të shpeshta në Republikën e Maqedonisë janë: Jugori, Vardareci, Veriori.

Në varësi prej klimës është e zhvilluar edhe bujqësia (rafshnaltat) dhe blegtoria (malet). Klima e volitshme mundëson kushte për kultura në Luginat e Strumicës-Radovishit dhe Gjevgjelisë-Vallandovës.

**Uji** është faktor, i cili drejtpërdrejt ndikon në zhvillimin e ekonomisë.

## Pasuritë xeherore – faktor për zhvillimin e ekonomisë

Gjej fotografi dhe shkrime për pasuritë xeherore në Republikën e Maqedonisë. Mëso vall ka ndonjë minierë në vendin tënd dhe çfarë xeheh nxirren. Kërko fotografi të xeheve në shkollë dhe shënoji ato: emrin e xeheh, ngjyrën, peshën... dhe nga vjen ajo. Shfrytëzoje hartën e Republikës së Maqedonisë.



**Minierë për bakër – Buçim – Radovish**



**Nxërrje e mermerit – Prilep**

Pasuritë xeherore janë faktor nga i cili varet zhvillimi i ekonomisë dhe industrisë. Maqedonia është e pasur me xehe të ndryshme: **thëngjill** (Manastir, Kërçovë, Mariovë) **xehe plumb – zink** Malet e Osogovës; bakër (Buçim në Radovish). Në përbërjen e bakrit ka dhe **ari, argjend, antimon**.

Në Republikën e Maqedonisë njerëzit merren me **xehtari**, në fakt me përpunimin e xeheve – **industri e rëndë**.

## Relievi dhe zhvillimi i ekonomisë



Rikujtohu për relievin e Republikës së Maqedonisë!  
Sipas ngjyrës së hartës gjeji edhe rafshirat!



**PELLAGONIA**

Maqedonia është vend malor. Malet më të mëdha në pjesën jugore janë: Malet e Osogovës, Ograzhdenit, Maleshevës, Bellasicës...

Në pjesën perendimore: malet e Sharrit, Bistrës, Korabit...

Njerëzit, të cilët jetojnë në male, më së shumti merren me **blegtori** dhe me përpunimin e mishit, qumështit, dhe pambukut.

Ndërmjet maleve të Republikës së Maqedonisë ka dhe rrafshira. Rrafshirat më të mëdha janë: rrafshira e Pellagonisë (drithënorja e Maqedonisë), e Pollogut, e Tikveshit, e Ovçe Poles, Lugina e Shkupit, Lugina e Gjevgjelijës-Vallandovës....

Njerëzit, të cilët jetojnë në sipërfaqe të rrafshëta merren me **bujqësi** si dhe me përpunimin e pemëve dhe perimeve.

Me përpunimin e prodhimeve të këtyre degëve zhvillohet industria **ushqimore, e tekstilit dhe e lëkurës**.



**Bëj ofertë turistike!**

Qëllimi i udhëtimit: **Noftoju bukuritë e Maqedonisë!**

Plan për vizitë të: zbulimeve arkeologjike, monumenteve kulturore- historike, pjesëmarrjes së një manifestim kulturor, atraksione natyrore...

### UNË E FILLOVA UDHËTIMIN TIM

Qyteti **Ohër është margaritar** i Ballkanit. Me arkitekturën e tij tradicionale është përfshirë në listën e **UNESKO-s** për trashëgimi kulturore dhe natyrore. Ohri ka qenë djep i shkrimit (mësimit) sllav. Atje gjendet froni i car Samoilit, amfiteatri romak, kisha dhe manastire, muzeu kombëtar, magraritarët e Ohrit...



**Ohër – Liqeni i Ohrit**



**Mavrovë**

**Liqeni i Mavrovës** edhe pse është artificial, megjithatë ai josh me bukurinë e tij kur shihet nga fushat e skijimit të malit Bistra. Liqeni ofron shumë mundësi: peshkim, kampim, shëtitje... Parku kombëtar i Mavrovës është i pasur me lloje të rralla bimore dhe shtazore.

**Galiçniku** me arkitekturën e tij autentike, me trashëgiminë e pasur kulturore, kultivimin e dokeve popullore – Dasma e Galiçnikut dhe me natyrën pitoreske paraqet një atraksion turistik.



**Dasma e Galiçnikut**



**Liqeni i Matkës**

Gryka e Matkës është e njohur si gryka e fluturave, me mbi shtatëdhjetë lloje fluturash endemike të natës dhe të ditës, më shumë lloje marimangash endemike, bimë endemike etj.



**Krushevë – etnoqytet**

Përpuno hartë turistike të Republikës së Maqedonisë! Ajo do të ndihmojë në udhëtimin.



**Turizmi** është degë ekonomike, i cili është i përqëndruar në organizimin e udhëtimeve dhe akomodimeve. Njerëzit udhëtojnë për pushime, për argëtim, për rehabilitim, për vizitë të vendeve kulturore dhe ngjarjeve sportive, atraksione natyrore, monumente historike.

Në Republikën e Maqedonisë janë të zhvilluar **turizmi malor, liqenor dhe lumor**. Gradualisht zhvillohet dhe **turizmi fshatar**.

Për shumë tursitë të vendit dhe të huaj atraktive janë **shpellat**, parqet kombëtare, lumenjtë e shpejtë malorë, **monumentet dhe burimet historike, rrallësitë natyrore...**

Turizmi është degë e rëndësishme e ekonomisë në shtetin tonë. Zonë më e madhe turistike është bregdeti i Liqenit të Ohrit, dhe pastaj edhe Liqeni i Prespës dhe Liqeni i Dojranit.

Nga qendrat turistike dimërore dhe malore më të rëndësishme janë: Popova Shapka në Malet e Sharrit, Mavrovë në Bistra, Strezhevë dhe Kopanki në Baba, Krushevë në Mali i Bushit, Berovë në Malet e Maleshevësi etj.

Turizmi lumor zhvillohet pranë lumenjve. Atje gjejmë peshkatarë...Në ujërat e rrëmbyeshëm të lumit Treska zhvillohet sporti lundrimor ose kajaku në ujërat e rrëmbyeshëm.

Në Maqedoni ekzistojnë shumë shpella dhe gërmime arkeologjike (Heraklea, Stobi, Skupi ...), bukuri natyrore (Kokino).

Në fillim prej teje kërkohet të mbledhësh materiale për vendet e bukura në vendin tënd dhe në Republikën e Maqedonisë. Materialin shfrytëzoje tani. Përpuno **projekt** në temë: Lokalitetet turistike në atdheun tim. Puno vet ose në grupe.



## ÇFARË KEMI MËSUAR?



Prej çka varet se cila degë ekonomike do të zhvillohet në një vend?

Në cilat degë ekonomike ndikon klima?

Cilat erëra fryjnë në Republikën e Maqedonisë? Në cilën pjesë fryjnë erërat e (Vardareci )Vardarit?

Cilat pasuri xeherore ekzistojnë në vendin tonë?

Cila degë industriale zhvillohet me përpunimin e xeheve?

Si ndikon relievi në tokën pjellore për zhvillimin e ekonomisë?

Cilat janë malet më të mëdha në Maqedoni?

Cila degë ekonomike është e zhvilluar në viset malore?

Cilat janë rrafshirat më të mëdha në Maqedoni?

Cilat degë ekonomike janë të zhvilluara në rrafshira?

Cilat degë industriale zhvillohen me përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe të blegtorisë?

Shkurtimisht përshkruaj çfarë di për turizmin.

Sqaro në cilat vende zhvillohet turizmi.

Emëroji qendrat turistike sportive dimërore më të njohura në Maqedoni.



## JETA KULTURORE DHE INSTITUCIONET E KULTURËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

**Kultura** është çdo gjë që ka krijuar shoqëria njerëzore dhe që ekziston si pasojë e punës trupore dhe mendore të njerëzve. Kultura është tërësi e ndërlikuar dhe përbëhet nga tre pjesë të lidhura ndërmjet veti:

**Kultura materiale**

**Kultura shpirtërore**

**Kultura kombëtare**

**Aktivitetet:**

Bëni hulumtim, mësoni dhe diskutoni çfarë e përbën kulturën si veçori e njeriut!

Vizitoje bibliotekën në vendin tënd ku jeton dhe mëso diçka më tepër për mënyrën e grumbullimit, mirëmbajtjen dhe botimin e librave.

**Biblioteka** është institucion në të cilën grumbullohen, rregullohen dhe mbahen libra, të cilat u jepen në përdorim anëtarëve të bibliotekës. Në bibliotekat përveç libra, ka gazeta, revista dhe mund të gjenden edhe inçizime muzikore, foto, filma, harta etj.



**Biblioteka universitare – Shkup**



**Skenë nga interpretimi teatral**

**Teatri** është lloj i artit skenik, i cili merret me interpretimin e teksteve dramatike para publikut me ndihmën e të folurit, gjesteve, muzikës etj. Në artin teatral marrin pjesë interpretimet me kukulla, opera dhe baleti.

**Opera** është vepër muzikore skenike, e cila në vete bashkon më shumë arte: muzikën, baletin, interpretimin vokal dhe artin figurativ përmes dekorimit dhe veshjes.

**Baleti** është vepër muzikore skenike në të cilën vallëzimi përdoret si mejt i shprehjes dhe është mbështetur nga orkestri, i cili interpreton muzikë klasike.



**Interpretim baleti në teatrin kombëtar maqedonas**

Njoftojuni me repertoarin e teatrit më të afërm dhe organizoni vizita në shfaqjet teatrale!



**Festivali ndërkombëtar** i kamerës së filmit “**Vëllezërit Manaki**” mbahet çdo vjet në Manastir. Festivali ka karakter garues në fushën e artit filmik.

**Kinemaja** është hapësirë ku shfaqen filma përmes projektorit në kinematografi. Sallat e kinemasë janë të ngjashme si ato të teatrit. Kinemaja mund të ketë edhe më shumë salla në të cilat jepen filma të ndryshme.

Gjatë vizitave të institucioneve kulturore shumë është e rëndësishme që t'i respektosh rregullat për sjellje të mirë, t'i respektosh artistët, si edhe publikun, kurse ajo do të thotë të sillesh mirë.

Në Republikën e Maqedonisë krijojnë autorë të shquar, siç janë shkrimtarët, **poetët, artistët figurativë dhe muzikorë, regjisorët, shkencëtarët.**

“**Vera e Ohrid**” është një ndër manifestimet më të rëndësishme në Republikën e Maqedonisë, e cila me dinjitet i paraqet vlerat kulturore të shtetit tonë në Evropë dhe në botë.

#### **Detyrë:**

Gjej të dhëna për personat e njohura nga fusha e letërsisë dhe e artit.



**Mbrëmjet poetike të Strugës**

“Mbrëmjet poetike të Strugës” paraqesin një tubim botëror të poezisë në të cilën jepet mirënjohja më e lartë për veprimtari poetike – “Kurora e artë” dhe shpërblimi “Vëllezërit Milladinovi” për libër më të mirë poetik nga autor maqedonas ndërmjet dy festivaleve poetike.

**Hulumto** dhe mëso cilat manifestime të tjera kulturore mbahen në Maqedoni!



## RELIGJIONET DHE BASHKËSITË FETARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË




Bisedë në temë – Si familja ime i shënon festat e mëdha fetare? Duke shfrytëzuar teknikën DDM (di, dua të di, mësoj) zbuloj për religjionet dhe festat fetare!

Di	Dua të di	Mësoj
Çfarë mendojmë se dimë për religjionet dhe bashkësitë fetare?	Çfarë dëshirojmë të mësojmë?	Çfarë kemi mësuar?




Tempulli i Kryepeshkopatës  
“Shën Klimenti i Ohrit”



Bibla

Kisha katolike



Xhamia

Kurani

**Religjioni** është besim në qeniet mbinjerëzore ndaj të cilave besimtarët kanë ndjenja të veçanta, praktikojnë rituale dhe ceremoni, respektojnë simbole të caktuara dhe organizohen në organizatat religjioze.

Në Republikën e Maqedonisë dominojnë religjioni krishter dhe islam.

Religjioni krishter është bazuar në jetën, të mësuarit, dhe veprat e Jezusit. Në suaza të krishterimit ekzistojnë besimi ortodoks, besimi katolik dhe protestant.

Krishterët ortodoks organizohen në kishën ortodokse maqedonase Kryepeshkopata e Ohrit. Një pjesë e besimtarëve ortodoks organizohen në kishën katolike, Evangjeliste-metodistike dhe bashkësitë të tjera më të vogla fetare.


Anëtarët e islamit besojnë në Allahun, kurse Muhamedi është profet, dhe organizohen në Bashkësinë fetare islamike në Republikën e Maqedonisë. Objektet fetare janë xhamitë dhe medreset. Kësaj bashkësie fetare i takojnë shqiptarët, turqët, boshnjakët, romët dhe myslimanët maqedonas.

E përbashkëta për të gjitha religjionet janë bindjet për: **Paqe, harmoni, dashuri, t’u ndihmohet të sëmurëve, të dobtëve dhe të varfëve, dhe të mos u shkaktohet sëmundje njerëzve rreth nesh.**

Në Republikën e Maqedonisë ka përkatës edhe të fesë çifute. Ata organizohen në Bashkësinë çifute fetare.



Kisha evangjeliste-metodistike



Sinagoga

## ÇFARË KEMI MËSUAR?

Si e kupton fjalën kulturë?

Cilat institucione kulturore i ka në vendin tënd?

Shpjegoje sjelljen tënde gjatë vizitës të ndonjë institucion kulturor.

Çka nënkupton me fjalën **bashkësi fetare**?

Shpejgo fjalën **religjion**?

Cilat janë religjionet më të mëdha në Republikën e Maqedonisë?

Numëroji dallimet ndërmjet religjionit krishter dhe mysliman dhe objekteve religjioze.

Çka mësojnë të gjitha religjionet?



### Hulumtim

Festat më të mëdha fetare të besimtarëve në vendin tim.

## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Çdo njeri ka të drejtat e tij, mirëpo dhe përgjegjësi ndaj vetës, ndaj të tjerëve në shoqëri, pa dallim të besimeve dhe religjionit, ndaj ligjeve dhe ndaj Kushtetutës së shtetit.

**Të drejtat e njeriut** sipas ligjit në vendin tonë, dhe sipas Konventës evropiane për të drejtat e njeriut janë:

1. **E drejta e lirisë** ( nëse nuk e ka shkelur ligjin)
2. **Të drejtën për të jetuar** (askush nuk duhet që me qëllim të vritet)
3. **Të mos jetë i malltretuar** (të jetë i nënçmuar)
4. në punë
5. **E drejta e lirisë dhe sigurisë i. Secili ka të drejtë në gjykim të drejtë.**
6. **E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare.**
7. **Liria për besim, ndërgjegje dhe religjion**
8. **E drejta martesore**
9. **E drejta për t'u mjekuar dhe barna**



**Të drejtat, të cilat dëshiron t'i kesh, lejo që t'i ketë secili, vetëm ashtu do bëhesh i lumtur.**




Përpuno një T-tabelë me të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

# PERSONALITETI NË GRUP DHE NË SHOQËRI

DO TË BJSEDOJME PËR:

- Si e kalon kohën e lirë dhe me kë;
- -personalitet dhe grup;
- -arsyet për egoizëm;
- -solidariteti si karakter i personalitetit;
- -pse familja është faktor i rëndësishëm për zhvillimin e personalitetit;
- -arsyet për sjellje devijante;
- sjellja jote e mirë dhe e keqe.



DO TË MËSOJME PËR:


- jetën private dhe shoqërore;
- socializimin e personaliteti
- solidaritetin dhe egoizmin
- faktorët e socializimit
- rregullat e sjelljes në mjedisin dhe detyrimet;
- devijimi dhe sjelljet devijante;
- të drejtat njerëzore dhe detyrimet;
- konfliktet dhe zgjidhja e konflikteve

DETYRA JOTE DO TË JETË:

- të përgatisësh pllakat për sjelljet egoiste dhe T-tabela në të cilën do t'i shfaqësh arsyetimet tuaja
- të përpunosh ese për “Grupin të cilës i takoj”
- të shkruash tregim në temë “Solidariteti im i bën të qeshin shumë njerëz”
- të hulumtosh për ambasadën e fëmijëve, për detyrat dhe punën e saj.



## JETA PERSONALE DHE GRUPORE



Unë jam i veçantë dhe dallohem nga të tjerët. Kam karaktertikat e mia personale, shakthësitë, si dhe gjëra të cilat dua t'i ndryshoj.

Unë jam personalitet dhe dallohem nga të tjerët sipas karakteristikave psikike, biologjike dhe sociale.



Personaliteti është bashkim i të gjitha veçorive (psikike, proceseve dhe sociale), të cilat njeriun e bëjnë të veçantë. Në formimin e njeriut ndikon trashëgimia, mjedisi, familja, shkolla dhe grup moshatarësh.

### LOJË

Disa fëmijë mbahen për dore dhe formojnë rreth! Një nxënës paraqitet vullnetar për t'u futur në rreth në çfarëdo mënyre. Mirëpo, qëllimi është që fëmijët t'i mbajnë duart fort dhe të mos lejojnë që të shkëputet rrethi. Kjo është vetëm lojë, mirëpo si ndihen anëtarët e rrethit? Si ndihet nxënësi i cili në çdo mënyrë përpiqet të hyjë mbrenda rrethit?

## ÇKA PARAQET GRUPI?



Bëju pjesë e grupit, por respektoji mundësitë tuaja, nevojat, idetë, vlerat dhe ankesat!

## SI E KALON KOHËN E LIRË?

### I takoj një grupi të caktuar



Njerëzit kanë nevojë të jenë pjesë e ndonjë grupi, të shoqërohen dhe të jenë bashkë me njerëz të tjerë. Shumë është e çuditshme ndjenja kur kemi dëshirë të jemi pjesë e një grupi, mirëpo nuk mundemi. Të gjithë ne jemi të vetëdijshëm që një pjesë të kohës e kalojmë me grup njerëzish – me moshatarë tanë, me prindërit, me të rriturit, me fqinjët, me të afërmit etj.

Në familje, shkolla, oborr, rrugë dhe në shumë vende të tjera ne e kalojmë kohën tonë. Në grup ne komunikojmë, shkëmbejmë informacione, mendime, ide, ndjenja, përkrahje dhe shoqërohemi.



Në grup personaliteti im mund të vijë në shprehje të plotë.

Grupi më respekton, përkrah, vlerëson dhe jam shumë e sigurtë në sjelljen time.

Grupi më mbron prej shtypjeve të jashtme, dhe ndjehem shumë më i sigurtë.

Ndjej afërsi dhe sinqeritet në grup. Rolet në grupe janë të ndryshme.



Ekzistojnë **grupe formale**. Ato kanë strukturë të përcaktuar dhe janë të organizuar në mënyrë speciale për të deleguar rolet e anëtarëve. Të tillë janë shkollat, sekcionet shkollore, klubet sportive etj. Në grupet formale është e rëndësishme që më parë të përcaktohen rolet për anëtarët që ajo të funksionojë me sukses dhe t'i kryejë detyrat.

### Paramendoni si do të ishte futboli pa i përcaktuar rolet e futbollistëve?

Ekzistojnë edhe **grupe joformale**. Një pjesë të tyre u përkasim edhe ne. Të tilla janë: grupi i moshatarëve, grupi i adhuruesve të së njëjtës muzikë, grupi i motrave dhe vëllezërve etj.

Shumë e rëndësishme është që të respektohen rregullat në grup. Kur marrim vendime na ndihmon shumë nëse e dimë cakun që duam ta arrijmë. Për të arritur cakun duhet të dimë se çfarë aktivitete duhet të ndërmarrim. Po ashtu, e rëndësishme është që të respektohet mendimi i secilit në grup dhe është e rëndësishme që secili të jetë përgjegjës për realizimin e qëllimit.



Grupi në të cilin dëshiroj të jem unë

### ÇFARË KEMI MËSUAR?




- Çfarë është personaliteti?
- Cilat janë grupet formale?
- Për cilat grupe themi se janë joformale?Pse?
- Cilin rol në grup më mirë e ndjeni në shkollë?

### letër Veprimtaria: duke e bërë

Mendo, konsulto literaturën, bisedo me të moshuarit dhe shkruaj një ese në bazë të këtyre pyetjeve:  
Si krijohen grupet?  
Çfarë është ajo që i motivon njerëzit të shoqërohen?  
Në çfarë mënyre njerëzit komunikojnë në grupe?  
Sa lloj grupesh ekzistojnë dhe cili është dallimi ndërmjet tyre?  
Pse është i rëndësishëm aktiviteti në grup?

## SOCIALIZIMI I PERSONALITETIT NË GRUP



**DEBATI:**  
Lexojini pyetjet, diskutoni dhe merrni qëndrim në lidhje me çështjet!  
Çfarë do të thotë për ty fjala solidaritet?  
A je ti solidar? Kur?  
Si do të sillesh nëse në shoqërinë tënde ke shok, i cili nuk do të ndajë asgjë me ty dhe jep rezistencë? A sillesh ndonjëherë ashtu? Pse?  
Çfarë do të kishe bërë në qoftë se dikush do të kishte kërkuar ndihmë prej teje?  
A pret çdoherë të kërkoresh ndihmë ose di më saktë të vlerësosh kur dikush pret përkrahjen tënde?  
Sqaro!



**ÇFARË ËSHTË SHOQËRIA?**


Shoqëria është bashkësi e organizuar njerëzish në të cilën ata krijojnë vlera materiale dhe kulturore dhe jetojnë sipas rregullave të përcaktuara.

Sjellja e personit në grup varet nga niveli i socializimit.

**Socializimi** paraqet proces ku personi e mëson dhe miraton mënyrën e sjelljes në shoqëri, grup dhe kështu adaptohet në jetë. Më vonë i përvetëson karakteristikat e tij personale. Ai mësim realizohet përmes lidhjes reciproke ndërmjet anëtarëve në një shoqëri dhe realizohet gjatë gjithë jetës.



**Socializimi i personit në grup**



Personi në grup arrin sukses më të mirë. Kjo është kështu për shkak përpjekjeve të përbashkëta të anëtarëve në grup. Në grupin zgjohet ndjenja për shoqërim, **solidaritet**, miqësi. Kur anëtarët ndihmohen ndërmjet veti në grupi bëhet fjalë për **solidaritet**. **Solidariteti është veçori pozitive.**

Nëse fëmija nuk është mjaftueshëm e socializuar dhe i kënaq vetëm nevojat e veta, kurse nuk i respekton interesat e të tjerëve, bëhet fjalë për dukuri e cila quhet **egoizëm**.

### **Punë në grupe**

Bisedo për veprimet e ndryshme të egoizmit dhe solidaritetit, kurse më vonë përpuno pllakat dhe prezantoje para klasës!



**Pajtohem,  
sepse...**



**Nuk pajtohem  
sepse...**

Qëndrimi juaj  
në lidhje me  
çështjen shkruje  
në T-tabelë!  
A e arsyetoni  
egoizmin?

**Unë jam,  
SOLIDARITETI!**

### **ÇFARË KEMI MËSUAR?**





- Çfarë është socializimi?
- Kur fillon procesi i socializimit?
- A e ndjen veten i socializuar? Argumento!
- Për cilin person themi së është i pasocializuar? Si sillet ai person?
- Cilat karakteristika i ka personi i pasocializuar?
- Shpjegoji termat solidaritet dhe egoizëm!
- Bëj krahasim ndërmjet solidaritetit dhe egoizmit!

Në orën e gjuhës maqedonase shkruaj një temë me përmbajtje duke zgjedhur njërën nga titujt e mëposhtëm:

- Solidariteti im buzëqeshi shumë fytyra!
- Egoizmi e vret dashurinë në mua!



## FAKTORËT E SOCIALIZIMIT (FAMILJA , GRUP MOSHATARËSH, SHKOLLA, MAS-MEDIUMET)



**Bashkëpunim nxënës – mësues – prindër**

**Familja** përfaqëson bashkësi ndërmjet fëmijëve dhe paraardhësve. Ajo është e para, rrethi social më natyror dhe më i afërt në të cilën personi e fillon jetën dhe zhvillimin e tij. Me ndikimin e familjes përcaktohet dhe formohet marrëdhënia e parë në shoqëri. Dashurinë dhe sigurinë që fëmijët e fitojnë në familje nuk mundet askush ta zëvendësojë. Dashuria e ndërsjelltë i afron prindërit me fëmijët. Ndjenjën e sigurisë që familja ia dhuron fëmijëve ndikon në baraspeshën në jetën dhe zhvillimin e tyre. Nëse ajo mungon atëherë ndikon në moralin dhe zhvillimin mendor të fëmijët. Në ato familje, ku ekziston dashuria, komunikimi i ndërsjelltë, respekti, fëmijet zhvillohen në mënyrë normale, me ndjenjë respekti, emotivisht janë më stabilë dhe krenarë. Fëmijët në moshën parashkollore janë shumë emocionalë dhe për atë ndjenja më edukative për ato është dashuria. Studimet tregojnë se fëmijët, të cilët kanë qenë të anashkaluar nga atmosfera familjare, kanë ngecur prapa me zhvillimin e tyre.

Prindëri për zhvillimin e fëmijës duhet të paraqet model me të cilin ai duhet identifikuar. Shumë i rëndësishëm është dhe ambienti kulturor në familje, ku fëmija do të kultivojë vlera kulturore (art figurativ, libër, teatër, muzikë etj).



**Klasa**

**Shkolla** është institucion i atillë ku çdo anëtar mund ta tregojë vetën që vlen para vetes dhe të tjerëve. Kjo është një ndër faktorët e socializimit. Në klasë fitojnë njohuri, zhvillojnë veti pozitive, respektojnë rregulla të sjelljes dhe shoqërohemi. Gjatë procesit të edukimit dhe arsimimit të nxënësve duhet të punohet për ndërtimin e qëndrimit pozitiv ndaj shoqërisë, shkollës, familjes, prindërve dhe gjeneratës. Për rezultate pozitive të klasës kontribuojmë përmes suksesit individual.

**Grupi i moshatarëve** është grup joformal. Gjithashtu, ai është njëri ndër faktorët e socializimit. **Grupi i moshatarëve mund të ndikojë pozitivisht ose negativisht në socializimin e personit me sjelljen dhe veprimet e tij.**

SI GRUPI I MOSHATARËVE NDIKON NË MËNYRË POZITIVE DHE SI NË MËNYRË NEGATIVE?



**Shkolla**

**Mas-mediumet si një nga faktorët për socializim të personit**


Teknika – stuhi idesh, term mas-mediume.



**Mjetet për ndikim masiv** ose për komunikim siç janë: radioja, televizioni, shtypi, filmi, shtypi me përmbajtjet e tija të ndryshme dhe metodat, kanë për qëllim të informojnë dhe të ndikojnë në sjelljen e personave. Gjithashtu, ato ndikojnë në krijimin e qëndrimeve, mendimeve dhe pikëpamjeve ndaj shoqërisë, natyrës dhe jetës.

Duhet pasur parasysh se mjetet për komunikim masiv në rrethana të ndryshme kanë ndikim më të madh dhe më intensiv në formimin e personalitetit se sa faktorët tjerë.

**Duhet të jesh i informuar, mirëpo me kujdes se si i pranon informacionet!**



Shtypi ditor



### RRJETI I DISKUTIMIT

Sqaroje ndikimin pozitiv	<b>Mas-mediumet mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht.</b>	Sqaroje ndikimin negativ



- Cilat mas-medime më shpesh i përcjell?
- Sa orë i ndjek mas-emdiumet
- Bëj anketë me 20 respondentë (moshatarë tuaj) në serialet TV më të shikuara!



**Përdoreni teknikën KUB!  
Ndahuni në gjashtë grupe!**


**Mendoni, bisedoni, konsultohuni dhe bashkëpunoni ndërmjet veti në grup.** Respektojeni mendimin e huaj, dhe tregojë mendimin tënd.

Duhet të paraqitni më shumë shpjegime, me të cilat do t'i arsyetoni tuajat!



**Grupi i parë:**  
(në përgjithësi)

**faktorët e  
socializimit**



**Grupi i pestë:**  
(përdorim)

**Cili është roli  
i faktorëve në  
zhvillimin e personit?**

**Grupi i dytë:**  
(krahaso)

**Krahasoju shkollat  
dhe grupin e të  
moshuarve!**

**Grupi i gjashtë:**  
(diskuto)

**Pse faktorët e  
socializimit janë të  
rëndësishëm për  
personin?**



**Grupi i tretë:**  
(asoco)

**Familje-shtëpi  
dashuri, tolerancë ...**



**Grupi i katërt:**  
(analizo)

**Përfitime nga faktorët  
për socializim...**



### **Punë në çifte**

Nxënësit krijojnë qëndrim paraprak për filmin e shikuar më parë.

### **Punë në grupe – nxënësit ndahen në tre grupe:**

#### **PO, JO, Të Përmbajtur.**

2-3 çifte i ndajnë argumentet e tyre

Nxënësit me kujdes i dëgjojnë argumentet dhe marrin qëndrimin (PO, JO)

Derisa ka nxënës të përmbajtur atëherë qëndrojnë në mes, ata të cilën janë përcaktuar për PO nga njëra anë, ata për JO në anën tjetër.

Nxënësit me qëndrimete tyre diskutojnë dhe gjatë kësaj kohe mund të vijë deri te ndryshimi i qëndrimeve.

Pas debatit secili grup cakton nga një anëtar që ta përfundojë diskutimin e grupit.

## **Çfarë kemi mësuar?**

1. Çka është familja?
2. Si duhet të funksionojë një familje?
3. Cilët janë faktorët elementarë të socializimit?
4. Si ndikon grupi i moshave mbi formimin e personalitetit?
5. Pse shkolla është faktor i rëndësishëm për socializimin e personit?
6. Shpjego si është ndikimi i medimeve masive në socializimin e personit?
7. Cili është faktori më i rëndësishëm i socializimit? Pse?





## DEVIJIMI DHE SJELLJA DEVIJANTE E PERSONALITETIT NË GRUPIN



Shikojni me vëmendje fotografitë!  
Ç'vëren?  
Pse fëmijët janë në gjendje të tillë?  
A keni qenë dëshmitar i ndonjë dhune?



### Sjellje devijante

Në formimin e personalitetit ndikim negativ kanë:

- Dashuria e dobët prindërore dhe sjellja pasive e prindërve
- Konflikti ndërmjet prindërve
- Rreptësia e madhe ndaj fëmijëve ose liri e madhe
- Maltretimi fizik i fëmijëve
- Gjendja financiare e dobët
- Ndarja e prindërve etj.

Nëse mbizotërojnë këta faktorë, do të shfaqen prishje të marrëdhënieve familjare, dhe me këtë familja nuk do mundet t'i mundësojë fëmijës jetë të harreshme dhe të ngrohtë, kështu që fëmija përjeton trauma dhe pengesa në zhvillimin e tij. Atëherë vjen deri te anashkalimi i rregullave shoqërore dhe kulturore. Ky proces quhet **devijim**, ndërsa sjellja e personit **sjellje devijante**.



Sjelljet devijante janë krimi dhe narkomania.  
**Krimi** është anashkalim nga normat e përgjithshme. Personi i cili vepron kundër ligjit dhe në Kushtetutën në dobi të tij kryen krim.

**Narkomania** është, gjithashtu, sjellje devijante dhe ajo nënkupton konsumimin e drogës. Droga është e rrezikshme për jetën e njeriut. Ajo e shkatërron jetën e njeriut. Narkomania është e lidhur me krimin.

SPORTO DHE JETO SHËNDETSHËM!

STOP PËR  
DROGËN!

DROGA VRET!



1. Çka është devijimi?
2. Cilat janë arsyet për sjellje devijante?
3. A e dini ç'është telefoni SOS?
4. Çfarë do të kishe bërë nëse shoku yt sillet në mënyrë devijante?



Diskuto pas filmit të shikuar dokumentar – **Droga vret.**

Përpuno pano me fotografi, tekste dhe ilustrime të tjera në të cilan do kishe klasifikuar sjelljet e ndryshme devijante!

## RREGULLAT E SJELLJES NË MJEDIS DHE PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE



Përmes metodës së dialogut bisedoni për rregullat e sjelljes dhe respektimin e tyre.

Ndaji rregullat, të cilat zbatohen në klasën tënde!

Cilat sanksione i ndërmerri gjatë mosrespektimit të rregullave?



Jeta në në shoqëri është e rregulluar sipas rregullave të sjelljes. Pa ekzistimin e rregullave të përkufizuara qysh më parë nuk do kishin mundur të realizohen shumë aktivitete. **Rregullat** vlejnë njësoj për të gjithë. Në qoftë se nuk respektohen rregullat ose vjen deri te mosrespektimi i tyre pasojnë dënimet. Detyra që duhet kryer është **obligim**. Obligimet duhet t'i kryejmë, ndërsa rregullat t'i respektojmë.

### Rregullat e sjelljes së mirë në mjedisin shoqëror

Çdoherë të jesh i buzëqeshur, i përgjegjshëm, i dashur, i ndërgjegjshëm, i vetëdijshëm!

Ndihmoju të sëmureve dhe pleqve. Mos ofendo askënd.

Mos u vono! Në kohë eja në shkollë!

Bëju mik i besueshëm dhe shok i mirë.



Bëju bashkëbisedues i kujdesshëm!

Mirmbaje higjienën në klasë dhe kujdesu për inventarin.

Bëju i përgjegjshëm, aktiv, dhe i kujdesshëm. Bëju tolerant!

Mos hidh mbeturina. Kujdesu për gjelbërimin.



### Obligimet (mendo dhe vazhdo)

Vepro sipas rregullave të jetës në shkollë, në shtëpi, në lojë.




Ruaje mjedisin jetësor dhe ambientin në të cilin jeton.

Respektoji ndryshimet e të tjerëve.



Duaje dhe respektoje atdheun tënd.



### Çfarë kemi mësuar?



1. Si është e rregulluar jeta në mjedisin jetësor?
2. Çfarë mundësojnë rregullat?
3. Çfarë janë sanksionet dhe kur i zbatoni?
4. Në qoftë se në klasën tuaj nuk ka rregulla për sjellje të mirë, të gjithë së bashku (nxënësit) formulojini dhe merruni vesh për sanksionet dhe mosrespektimin e tyre.

# KONFLIKTI DHE ZGJIDHJA E TIJ



Bisedo për sjelljen tënde të mirë dhe të keqe.  
**Stuhi idesh:** Shikoj me kujdes fotot dhe bisedo në çka ju asocon. Cila fjalë ju asocon në konflikt?

Përgaditë T-tabelë

Sjellja ime e mirë	Sjellja ime e keqe



Zënka me pasoja të mundshme



Fjala konflikt nënkupton përleshje, zënkë, luftë, përdorim i forcës dhe dhunës.



Konflikt verbal

Të jetohet në mjedis shoqëror do të thotë çdo ditë të komunikohet me njerëz, të cilët kanë karaktere të ndryshme. Për të pasur konflikt duhet së paku të ketë dy persona.

Të dyja palët me sjelljet e tyre ndikojnë në situatën konfliktuoze me mendimet e tyre të kundërta, akuzime, ofendime, kërcënime. Në qoftë se nuk zgjidhet konflikti prishen marrëdhëniet e mira ndërmjet njerëzve.

Të gjithë ne kemi ide të ndryshme, mundësi, dëshira dhe nevoja (nga siguria, nga dashuria dhe miqësia, nga respekti, nevoja për ushqim, për vetafirmim dhe shumë nevoja të tjera). Kur i na

janë plotësuar dëshirat ne ndjehemi të kënaqur dhe të lumtur. Ndalimi për realizimin e dëshirave sjell konflikt.

Ekziston konflikt verbal dhe konflikti i përdorimit të forcës.

Simuloni konflikt përmes **luajtjen e roleve**, si dhe për zgjidhjen e tij.

**Grupi i parë:** Si do të reagosh nëse dikush me qëllim të godit? Nëse vjen deri te konflikti si do ta zgjidhësh.

**Grupi i dytë:** Nxënësit kanë detyrë përmes prekjes së sendit, pa parë, ta përshkruajnë dhe të tregojnë për cilin send bëhet fjalë. Nëse ka mendime të kundërta si do ta kishin zgjidhur konfliktin?

### Metoda për zgjidhe të konflikteve

Një nga mënyrat për zgjidhjen e konflikteve është **pajtimi**. Nëse konflikti zgjidhet tërësisht, pajtimi do të ketë sukses. Konfliktet janë të përditshme në jetën tonë dhe ne nuk mundemi t'u shmangemi. Megjithatë, para së gjithash, duhet të jemi tolerantë, të mësojmë të ballafaqohemi me konfliktet dhe të përpiqemi që t'i zgjidhim, çdoherë nëpërmjet bisedave.


**Toleranca** do të thotë durim, respekt në dallimet ndërmjet njerëzve, respektim i njerëzve.



Jep dorë që t'i largohesh konfliktit

### Çfarë kemi mësuar?


1. Ç'është konflikti?
2. Kur kemi konflikt?
3. Çfarë mund të jetë konflikti?
4. Numëroji metodat për zgjidhen e konflikteve dhe sqaroji!
5. Cila metodë për ty është më i pranueshme? Pse?



Në orën e **guhës maqedonase** shkruaj shkrim të shkurtër për përbërjen e konfliktit kur nuk është e kënaqur ndonjë dëshirë. Më vonë jep mendim për konfliktin.

## TË DRAJTAT E FËMIJËVE SI TË DREJTAT E NJERIUT

1. Rikujtoju për të drejtat dhe obligimet tuaja
2. Plotësoje prizmen me terminet kyçe të drejtat e njeriut dhe të drejtat për liri dhe siguri.



Bisedo për vlerat e tua. Në fletë shkruaji vetitë (karakteristike dhe fizike) të cilat të bëjnë që të jesh më ndryshe nga shoku yt.

**Marrëdhëniet ndërmjet njerëzimit në një shoqëri rregullohen me të drejta të caktuara.** Njerëzimit ndërmjet veti dallohen sipas: ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë etnike dhe fetare, gjuhës në të cilën flasin, pasuria, arsimit etj. Ndryshimet nuk duhet të jenë arsye që të mos shoqërohemi. Secili individ ka vlerën e tij. Vlerat e të gjithë njerëzve duhet të respektohen. Të gjithë njerëzimit duhet të jenë të **barabartë** ndërmjet veti. Nuk duhet të ekzistojë diskriminacioni për shkak të ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë fetare ose etnike.



**Barazia shikohet në të drejtat e barabarta për të gjithë njerëzimit.** Mirëpo barazia nuk mund të ndahet veçmas lirisë. **Liria nënkupton barazi për të gjithë para ligjit.** Të drejtat e njeriut janë universale dhe u takjonë të gjithë njerëzimit në botë.

**Deklarata universale për të drejtat e njeriut u miratua në Parlamentin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Paris, më 10 dhjetor të vitit 1948.**

**Të drejtat e njeriut më të rëndësishme janë këto:**



UNICEF-i është organizatë pranë Kombeve të Bashkuara, e cila kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e jetës së fëmijëve.



### Punë në grupe:

Fëmijët të ndahen në grupe dhe secili fëmijë në fletë të shënojë nga një të drejtë për të cilën do të bisedojnë nga Konventa për të drejtat e fëmijëve. Grupet kanë për detyrë të bisedojnë për të drejtën dhe shkeljen e saj. Grupet mund të përgatisin edhe situata në të cilat do kishin aktruar.




Duke u nisur nga Deklarata për të drejtat e njeriut, edhe fëmijët i gëzojnë ato të drejta sikur çdo krijes tjetër. Mirëpo fëmijët si grup i vaçantë kanë të drejta dhe përgjegjësi, të cilat rregullohen me Konventën për të drejtat e fëmijëve, e cila unanimisht ishte e shpallur në Kombet e Bashkura në vitin 1989. Republika e Maqedonisë këtë konventë e ka nënshkruar në vitin 1993.. Pra qeveria duhet të sigurojë që çdo fëmijë t'i gëzojë të drejtat nga konventa. Të drejtat e fëmijëve janë shumë të rëndësishme për shkak se vlerat në një shoqëri përcaktohen në bazë të respektimit të së drejtave dhe lirisë. Shkolla duhet të jetë vend në të cilin fëmijët do të mësojnë për të drejtat e tyre dhe si ato duhet të mbrohen.

## Të drejtat dhe detyrimet e fëmijëve

### Të drejtat e fëmijëve

Fëmijët kanë të drejtën për arsim



Çdo fëmijë ka të drejtë të jetojë dhe të zhvillohet lirisht, pa dhunë.



Çdo fëmijë ka të drejtë të flasë në gjuhën e tij dhe të ketë kulturën e tij.

### Obligimet e fëmijëve

Rregullisht të shkojë në shkollë.

Respektimi i prindërve të tij.



Kujdesu për shëndetin tënd.



?

Respektoje mendimin e huaj.

Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë në paqe dhe liri.

?

?

Ruaje dhe mos e ndot mjedisin jetësor.

Askush unka të drejtë t'i ofendojë fëmijët.

?

?

Mos i diskrimino njerëzit rreth teje.

Fëmija ka të drejtë për intimitet.

?

### Fëmijët mësojnë ...

- Nëse fëmija jeton me lavdërim, do të mësojë të vlerësojë.
- Nëse fëmija jeton me kritikë, do të mësojë të gjykojë.
- Nëse fëmija jeton me sinqeritet, do të mësojë ç'është e vërteta.
- Nëse fëmija jeton me frikë, do të mësojë të frikësohet.
- Nëse fëmija jeton në barazi, do të mësojë ç'është drejtësia.
- Nëse fëmija jeton me tolerancë, do të mësojë të jetë i durueshëm
- Nëse fëmija jeton me inkurajim, do të mësojë të jetë i sigurt në vetveten.
- Nëse fëmija jeton me mirënjohje, do të mësojë se është mirë të ketë qëllim.
- Nëse fëmija jeton në siguri, do të mësojë të besojë në vetveten dhe në të tjerët.
- Nëse fëmija jeton me pranim dhe akordim, do të mësojë ta duajë vetveten dhe të tjerët.
- Nëse fëmija jeton me respekt dhe miqësi, do të mësojë si të gjejë dashuri në botë.




1. Çfarë janë ato të drejta?
2. Shpjegoje barazinë dhe të drejtat e njeriut.
3. Pse themi se Deklarata për të drejtat e njeriut është universale?



Ndajuni në grupe dhe hulumtoni cilat janë qëllimet dhe detyrat e ambasadave të fëmijëve.  
 Cila është ambasada e parë e fëmijëve?  
 Kush tjetër kujdeset për të drejtat e fëmijëve?

# ÇFARË KAM MËSUAR



**0800 1 2222** - NUMRJI FALAS SOS PËR FËMIJË DHE TË RJNË PRANË AMBASADËS SË PARË NË BOTË - **MEGJASHJ**. FËMIJËT DHE TË RJNËTË MUND TË PARAQITEN DHE TË FLASJN PËR PROBLEMET QË J KANË.  
**ÇDO DITË PUNE PREJ ORËS 8.00 DERI NË ORËN 20.00.**

FJALË KYÇE  
DEVJËJMJ  
ALKOOLJZMJ  
NARKOMANJA  
KONFLIKTJ



1. Për cilin person themi se është i socializuar? Sqaro!
2. Cila është arsyeja për sjellje devijante?
3. A e ke shfrytëzuar deri tani telefonin SOS? Pse?
4. Numëroji të drejtat e fëmijëve dhe obligimet?
5. Çfarë do të kishit bënë, në qoftë se shoku apo shoqja juaj do të gjendej në situatë konfliktuozë?

# REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BOTË

## DO TË BJSEDOJMË PËR:

- Faresin dhe miqtë që jetojnë në diasporë
- Arsyet për shpërnguljen nga vendi ynë
- Pse është i rëndësishëm anëtarësimi në Unionin Evropian
- Burimet potenciale të energjisë



## DETYRA JUAJ DO TË JETË:

- Të vizitosh gërmime arkeologjike
- Të hulumtosh për trashigimitë kulturore të Maqedonisë
- Të përgatisësh raport për monumentet kulturore të Maqedonisë
- Të realizosh projekt në temë "Takimi im me një të huaj"
- Të shkruash shkrim në temë "Një i shpërngulur shpjegon"
- Hulumto në rolin e gazetarit për të huajt në Republikën e Maqedonisë dhe arsyen e vizitës së tyre
- Të përgatisësh shirit kronologjik të Unionit Evropian
- Të përpunosh një ditari për problemet botërore globale

## DO TË MËSOJMË PËR:

- Trashigimitë kulturore në Republikën e Maqedonisë
- Shkaqet e shpërnguljes nga vendi ynë RM
- Monumente të kulturës
- Të huajtë në Republikën e Maqedonisë
- Unioni Evropian
- Integrimet evropiane
- Globalizimi dhe problemet globale
- Energjia dhe mundësitë alternative
- Bota globale dhe komunikacioni



## TRASHËGIMIA KULTURORE NË TRUALLIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



Shiko me kujdes fotografitë !  
Cilat objekte i njeh?  
A ke vizituar ndonjë prej tyre?  
Numëroji disa qytete që i di nga e kaluara!

KALAJA E  
SHKUPJT



ÇARSHJA  
TURKE



XHAMJA E  
LARME



KËSHITJELLA  
E SAMOJLJT




GALJÇNJJKU



OHRJ



Maqedonia ka një të kaluar të pasur historike dhe kulturore.  
Çdo qytet, çdo lagje krenohet me të kaluarën e tij. Njerëzit me kënaqësi dhe interes të  
madh mësojnë për trashëgiminë nga e kaluara.  
Janë gjetur shumë lokalitete arkeologjike dhe mbeturina nga ndërtime të vjetra, kisha,  
manastire, xhami, freska. Ato flasin për trashëgiminë e **pasur kulturore** të Republikës  
së Maqedonisë.



Shumë ndërtime nga e kaluara janë shkatërruar nga tërmete, nga vërshime ose zjarre, por edhe nga rrënime në kohëra të luftës. Sot nga ato ndërtime të së kaluarës shumë njerëz bëjnë restaurimin e tyre, që të duken si më parë.



**Arkeologjia** është shkencë që merret me gërmimin dhe hulumtimin e objekteve të kulturave të vjetra.  
**Arkeologu është shkencëtar që e hulumton jetën e njerëzve të parë dhe objektet që ata kanë lënë pas tyre.**



Me arsimtarin vizitoni gërmime arkeologjike  
 Bëj punim me shkrim (raport) për vizitën.



**Hulumtim të vazhdueshëm:** Grumbullo të dhëna themelore - fotografi për trashëgiminë kulturore të Maqedonisë.

Dëshmitë për këtë janë zbulimet arkeologjike në territorin e vendit tonë. Gërmime të rëndësishme janë bërë në: **Pellagoni, Trebenishtë - Ohër, Maxhari- Shkup, Tarinci – Shtip** dhe në shumë vendet të tjera në shtetin tonë. Një numër i madh i paisjeve nga keramika dhe mjete nga guri gjenden në **muzeumet e Maqedonisë**.

Në gjithë territorin janë gjetur mbeturina që i takojnë periudhës të Maqedonisë antike. Të rëndësishme në kohën e sotshme janë mozaikët dhe skulpturat, në qytetet: **Heraklea – Manastir, Stobi** afër Demir Kapisë, **Lihnidos –Ohër, Skupi – Shkup** etj.



Mozaikë të Heraklesë

**Kokino** gjendet në afërsi të Kumanovës dhe është **observatori më i vjetër në Ballkan**.



Kështjella të ruajtura deri më sot janë: **Kalaja e Shkupit, Kështjella e Samoilit në Ohër, Kullat e Markut në Prilep**.

Spikatje të posaçme paraqet **arkitektura e ndërtimit**, e cila mund të përjetohet në pjesët e vjetra të **Ohrit, në Krushevë dhe Çarshinë e vjetër të Shkupit**.




## Përmendoret e kulturës

Grumbullo informacione themelore për ndonjë përmendore që gjendet në afërsi të vendbanimit tënd.

**Përgatit raport sipas planit në vijim:**

1. Kur është ndërtuar?
2. Kush e ka ndërtuar?
3. Për çfarë është shfrytëzuar në të kaluarën?
4. Çfarë prezenton sot?



Trashigimia kulturore e Maqedonisë është shumë e pasur me një numër të madhë objektsh të vjetra, kisha, manastire, në ndërtimin e së cilave kanë marrë pjesë mjeshtër të përsosur. Ata me mjeshtërinë e tyre kanë krijuar vepra të mrekullueshme në brendinë e manastireve dhe të kishave.



**Freskëpikturimi** (pikturimi në mur) është njëra ndër pjesët më të mira të artit bizantin. Piktoret e freskave, nën ndikimin e kulturës krishtere, kanë krijuar freska me vlera të jashtëzakonshme.



**Freska –Manastiri i Lesnovskit**



**Qarrja e Jezusit**



**Ikona e Shën Mërisë**

**Drugdhendja** – (arti i drugdhendjes) drugdhendësit me ndihmën e pykës të hekurt kanë krijuar ikona të mrekullueshme, të cilat sot i zbukurojnë disa nga kishat maqedonase.



**Shën Spasi – autoportret kolektiv**



**Shën Jovan Bigori**



**Kollan kombëtar**



**Veshje kombëtare**



**Veshje kombëtare**



**Inxhi nga Ohri**

Pasuri kulturore janë edhe veshjet kombëtare, kollanet, këngët dhe vallet kombëtare, traditat, doket, festat etj.

Gjurmë të madhe në trashigiminë kulturore, posaçërisht në arkitekturë ka lënë ndikimi islamik, veçanërisht në arkitekturën e **objekteve fetare** – **xhami, hamame (banja), hane (flejtoje) ura, saat kulla** etj.




**ARKITEKTURA - OHËR**



**KURSHUMLJANJ - SHKUP**



**ÇIFTE HAMAM - SHKUP**



**MBRENDËSJA E XHAMISË SË LARME**

## Maqedonia – thesar multikulturor

MULTJKULTURA –  
DALLJMET KULTURORE,  
EKZISTIMET E  
SHUMË KULTURAVE.

Nga materialet e grumbulluara nga hulumtimi, në orën e artit figurativ, punoni pano me temën:  
“Maqedonia – thesar multikulturor”!



Gjatë shëkuqve janë zhvilluar shumë zejtarë disa prej tyre deri në përsosshmëri: **filigrania, keramika; këtu hyjnë edhe kazanpunuesit, opingëpunuesit ngjyrëlyerësit etj.**

**Nëse në afërsi të lagjes tënde gjendet ndonjë punëtori zejtarie vizitoje atë....  
Përshkruaj ndonjë aktivitet kohor në punëtorinë e zejtarisë.**

**Folklori** nëpërmjet këngës e këndon fatin e popullit maqedonas.

A di ndonjë këngë popullore maqedonase?

Cilat janë instrumentet karakteristike maqedonase?

Bëj krahasim – dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet melosin kombëtar maqedonas me melosin kombëtar të etnive të tjera.

Tradita dhe veshja kombëtare – janë pjesë e rëndësishme e kulturës së popullit tonë.

Shkrimet dhe letrat e shkruara në gjuhën popullore maqedonase, me alfabet qirilik, flasin për **gjuhën maqedonase**. Gjithashtu, edhe pjesëtarët e bashkësive etnike e kanë shkrimin e tyre. Për shembull, më 22 nëntor të vitit 1908 në Manastir u themelua alfabeti shqip.

**Hulumto: Prej kur rrjedh alfabeti i bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë!  
Përshkruaji doket e festës fetare që e festoni në shtëpinë tuaj!**

**Pozita e Republikës së Maqedonisë dhe ndikimi, posaçërisht të religjioneve, dhe më së shumti i krishterizmit dhe islamit, kanë kontribuar që të jetë bashkësi multikulturore.** Ndërtimet dhe monumentet e shumta nga e kaluara flasin që në territorin e saj janë gërshtuar shumë kultura.

**Mendo!**

Si duhet ta kultivojmë trashigiminë kulturore?



**Ohër, Lihnidosi antik,**  
përplot me gjurmë nga e kaluara,  
është i mbrojtur nga **UNESKO**.



## DIÇKA E PADETYRYESHME, POR E DOBISHME



### Të dhëna themelore

Çdo popull dëshiron ta ruajë trashigiminë kombëtare, përkatësish, pasurinë e të kaluarës së tij.

### Ku dhe si do të kishit ruajtur trashigiminë kombëtare, nëse nuk ekzistonin muzeumet?

**Muzeumet** janë institucione në të cilat bëhet grumbullimi, ruajtja dhe prezantimi i trashëgimisë kulturore – historike të Maqedonisë, nga parahistoria deri më sot.

Disa qytete të Maqedonisë kanë muzeume. Aty ruhen ekspozate të sendeve, dokumenteve, fotografive, librave etj.

Njerëzit (vizituesit) i vizitojnë muzeumet e ekspozitave të shumta të organizuara në të cilat kanë mundësinë ta ndjejnë frymën e të kaluarës dhe për një moment të jenë pjesë e historisë së kaluar, të cilën e kanë ndërtuar gjeneratat e kaluara. **Detyra kryesore e muzeut është** veprimtaria e muzeut - hulumtimi, grumbullimi, rregullimi, mbrojtja dhe ruajtja e materialeve të muzeut.

Në muze punojnë persona profesionalë – kustosë, të cilët i kanë të gjitha informacionet, dhe mundën të të sqarojnë gjithçka që të intereson në lidhje me ndonjë send të vjetër, dokument fotografi, mbishkrim etj.



## MUZEU I QYTETIT TË SHKUPIT

Muzeu i qytetit të Shkupit është i themeluar në vitin 1949. Nga viti 1970 bartet në pjesën e adaptuar të stacionit të vjetër hekurudhor të qytetit. Prej atëherë deri sot, muzeu e ndërlidh artin me qytetin e Shkupit.

**MËSO MË SHUMË:**

[www.muzejbt.org.mk](http://www.muzejbt.org.mk)

[www.museumstruga.mk](http://www.museumstruga.mk)



**RREGULLISHT VIZITO EKSPOZITA NË MUZE!**



## Hulumto!

Në qoftë se në vendbanimin tënd ka muze/muzeume vizitoje/i. Bisedo me të punësuarit dhe mbaj shënime. Dituritë e fituara shënoji në ditarin tënd - **Eksponate nga e kaluara ime.**

Në qoftë se në shkollë tënde organizohet EKSKURSION SHKENCOR nëpër vendin tonë, vizitoji muzetë në: Maqedoninë lindore – Entin dhe muzeun në Strumicë, Muzeun kombëtar në Gjevgjeli; Maqedonin perëndimore – Muzeun natyroro shkencor në Strugë.  
– Vizitoje muzeun e qytetit të Shkupit.

Për trashigiminë kulturore të vendit tonë kujdeset  
**Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë.**



## Çfarë kemi mësuar?

- Çfarë e përbën trashigiminë kulturore të një populli?
- Cili është observatoriumi më i vjetër në Ballkan?
- Cilat lokalitete arkeologjike i di në Republikën e Maqedonisë?
- Ku gjenden mozaikët më të njohur të periudhës antike?
- Cilat kështjella janë ruajtur deri sot?
- **Akritektura e vjetër qytetare është shenjë për cilat qytete?**
- Numëroji manastiret ose kishat të rëndësishme sipas freskave dhe gdhendjeve të vjetra?
  - Në cilat objekte shihet ndikimi islamik? Numëroji!
  - Cilat objekte janë shenjë të kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë?
  - Cilat zejтари të hershme i di?
  - Nën mbrojtjen e kujt është qyteti i Ohrit?
  - Çfarë institucione janë muzetë?
  - Ç'është pjesë e trashëgimisë bashkëkohore kulturore e Republikës së Maqedonisë?
  - Pse Maqedonia është thesar multikulturor?

## EMIGRIMI NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BOTË

Me kujdes lexoje tekstin (bisedën e tre fëmijëve). Shfaqe mendimin tënd. Secili prej nesh ka të afërm ose farefis dhe miq, të cilët janë shpërngulur nga shteti ynë dhe jetojnë në shtet tjetër, jashta kufijve të Republikës së Maqedonisë. Bisedo, jep mendim!



Unë jam nga Maqedonia, por jetoj me prindërit e mi në Australi.

Edhe unë jam nga Maqedonia, por jetoj me prindërit e mi në Francë.

Unë jam nga Maqedonia, por jetoj me prindërit e mi në Zvicër.

Sa vjet jetoni në Australi?

Gjyshi dhe gjyshja ime me prejardhje janë nga Maqedonia. Gjatë luftërave ballkanike janë shpërngulur nga Maqedonia në Paris, Francë, ndërsa unë kam lindur në Paris dhe jetoj në Francë. Por, atdheun tim nuk e harroj.

Unë jam i lindur në Maqedoni, në Gostivar. Prindërit e mi nuk ishin të punësuar. Kushtet për jetesë ishin të vështira. Gjithë këtë nuk e kuptoja se isha i vogël. Së pari, u largua babai im dhe pastaj unë, nëna dhe motra ime.

Maqedonia ka një të kaluar të gjatë historike. Banorët në Maqedoni gjatë historisë vazhdimisht janë shpërngulur.

### Hulumto!

Arsyet kryesore për shpërnguljen e popullsisë nga Maqedonia.



### **DEBATO: PO OSE JO** **TEMA: MUNDËSI MË TË MIRA JASHTË KUFIJVE TË MAQEDONISË**



Ndahuni në dy grupe.

Grupi i parë le t'i numërojë arsyet pse Po, dhe tjetra pse Jo.

**Debatoni**, duke respektuar mendimin e huaj, kurse e jepni mendimin tuaj. Duhet të jepni më shumë sqarime me të cilat do t'i arsyetoni qëndrimet tuaja.



Migracioni përfaqëson shpërngulje të popullsisë nga një vend dhe emigrim në një vend tjetër. Populli i Maqedonisë më shpesh emigron për këto arsye:

- **Arsye sociaile** – gjurmëve për jetë më të mirë
- **Arsye politike** – të dhunshme
- **Arsye religjioze**

Sipas asaj se ku zhvillohen, migrimet ndahen në të **brendshme dhe të jashtme**.

**Migrimet e brendshme** – shpërngulja e popullsisë nga një vend në një vend tjetër brenda kufijve të shtetit.

Si pjesë e migrameve të brendshme ekzistojnë **lëvizje ditore dhe sezonale**.

Kush merr pjesë në këto lëvizje?

**Migrimi i jashtëm** – shpërngulje në vend të jashtëm, jashtë kufijve të shtetit.

**Emigruesit** me vendin e tyre janë në kontakt nëpërmjet: **Agjencionit për emigrim, Ambasadat e Republikës së Maqedonisë, Konzulatet, Amza e emigrimit të Maqedonisë etj.**







Ata organizohen në **organizata emigruese**: shoqëri kulturore-artistike, klube, manifestime sportive, asociacione, shkolla, medime të shtypit, komuna kishtarë, televizione, radio etj.  
Emigruesit nga Maqedonia e kultivojnë gjuhën amtare, doket, traditat e vendit dhe popullit të tyre.  
Njëkohësisht ata janë të kyçur në afirmimin e Maqedonisë në botë.

**Diaspora Maqedonase e Bashkuar** ose DMB është organizatë ndërkombëtare e themeluar në vitin 2004, me seli në Uashington të SHBA-së, e cila kujdeset për interesat dhe nevojat e bashkësive maqedonase në mbarë botën.



**Shikoje fotografinë!**




**Diskuto!**

» Në cilat vende të botës ka më shumë emigrantë nga Maqedonia?



Në orën e **gjuhës maqedonase** bëj punim me shkrim në temë: **Një i mërguar tregon...**

## TË HUAJT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Zgjidhni njohuritë dhe mësoni më shumë për të huajt në Republikën e Maqedonisë!

Në rolin e **gazetarit-hulumtuesit** mëso:

(Më parë përgatit një listë me pyetje. Pyetjet duhet të jenë konkrete, të shkurtra dhe të qarta. Ndhimoi këtij hulumtuesi të ri ta përpilojë listën me pyetje).



Cilat janë përshtypjet e tyre për vendin tonë?

Cili është vendi i tyre?

Sa kohë dhe pse qëndrojnë në Maqedoni?

**I huaj** është personi, i cili nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë, ose personi i cili gjendet në territorin e një shteti, ndërsa ka nënshtetësi të një shteti tjetër.


**Vend i huaj** është gjithçka jashtë kufijve të shtetit ku jetojmë, përkatësisht me termin vend i huaj kuptojmë të gjitha shtetet tjera. Në Republika e Maqedonisë qëndrojnë shumë të huaj nga shumë shtete, më tepër nga shtetet fqinje. Por, ka edhe të huaj nga gjithë bota.

**Arsyet e qëndrimit (vizitës) të tyre janë nga më të ndryshmet:**

- turizmi (shtetin tonë e vizitojnë shumë turistë);
- përfaqësitë konzulare-diplomatike të shteteve të huaja në Republikën e Maqedonisë;
- misionet zyrtare për Qeverinë e tyre ose për Organizatën ndërkombëtare;
- Punësime, shkollime, specializime, hulumtime shkencore ose kryerja e ndonjë veprimtari të caktuar profesionale;
- kongrese, seminare e manifestime të ndryshme
- ngjarje politike, shkencore, kulturore, sportive ose fetare;
- kontrollime mjekësore,
- investime të jashtme etj.

Të huajt në Republikën e Maqedonisë dëshirojnë të njihen me trashëgiminë kulturore, traditën, doket dhe ushqimet tradicionale.

**Pse?**



Si nikoqirë të mirë mendoni:  
Si dhe në çfarë mënyre do t'ia prezantoni Maqedoninë një të huaji?



Kuriozitete kulturore  
Ushqime kombëtare  
Doke

## PROJEKTI MËSIMOR

Më mësuesin tuaj përgatituni për projekt mësimor!  
Përpunoni projekt hulumtues me temë:



### “Takimi im me një të huaj në Maqedoni”

Mos e harroni rrethin e rregullave!

Diskutojini dhe mësojini fazat e projektit!

Shfrytëzoni dituritë e mëparshme, përvojat, dhe dëshirën për zgjerimin e tyre!



## Udhëzues në aktivitetet tua hulumtuese

Formoni ekipe dhe përcaktojini detyrat!  
Përcaktojini kohën e duhur për përgatitje!

### Hulumtoni!

Vizitoni institucione dhe individë (persona)!

Bëni zgjedhjen e materialeve dhe informacioneve:


- shkrime nga gazeta, revista, internet, medium, fotografi;
- realizoni inetrvistë, bisedë me të huajë; në varësi prej mundësive, mund të shfrytëzoni telefon ose mail;
- njohuri personale ose nga më të riturit.

Përpiloni pyetje!

Përshtypjet dhe përfundiimet tuaja nga hulumtimi përgatitini mirë për prezantim!

Me arsimtarin dhe ekipin e tërësishëm projektues bëni vlerësimin e të gjitha materialeve!

## Çfarë kemi mësuar?



ИТО НАУЧИЛИМЕ?

- Çfarë është emigrimi?
- Çfarë emigrime kemi?
- Numëroji disa nga arsyet për emigrim!
- Në cilat vende ka më shumë të shpërngulur nga Maqedonia?
- Si janë të organizuar emigruesit në vendet e migruara?
- Nëpërmjet cilave institucione emigruesit mbajnë kontakte (lidhje) me atdheun e tyre?
- Çfarë është vendi i huaj?
- Për cilin person themi së është i huaj?
- Numëroji disa ambasada të huaja në Republikën e Maqedonisë?
- Çfarë më tepër i inspirojnë të huajt në vendin tonë?

## REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE INTEGRIMI EVROPIAN

Në ilustrimin është i paraqitur njëri nga shtatë kontinentet e botës.


Gjeje cili është ai kontinent?

Cilat shtete e përbëjnë atë?

A e di sa është numri i tyre?

Cili është shteti më i madh dhe cili më i vogël?

Cilat gjuhë fliten?



Evropa është kontinent me shumë shtete, nga më të voglat deri te më të mëdhatë. Shteti më i madh është Federata Ruse, ndërsa shteti më i vogël Vatikani. Fliten shumë gjuhë.



## Çfarë përfaqëson Unioni Evropian?



### Të dhëna të përgjithshme!

Unioni Evropian është bashkësi mbinacionale dhe ndërqeveritare të shteteve-anëtare demokratike.

Unionin Evropian e përbejnë 27 shtete evropiane, mirëpo ai është i hapur për zgjerim me shtete të reja.

**Unioni Evropain**, nën këtë emër, është themeluarë në vitin 1993, me Marrëveshjen e Mastritit, i cili është nënshkrur në vitin 1991.

Idetë për Evropën e bashkuar kanë ekzistuar edhe më parë. Historia e kontinentit bën përpjekje të vazhdueshme për bashkimin e popujve të ndryshëm evropianë. Mirëpo, dallimet që kanë ekzistuar ndërmjet shteteve dhe popujve në Evropë, kanë shkaktuar tensione, luftëra, konflikte. Katastrofat nga dy luftërat botërore, dëshira që të mos përsëritet tmeri dhe dëshira që Evropa të rindërtohet, janë forca lëvizëse për formimin e bashkësisë.

Në vitin 1951 gjashtë vende nga Evropa: Belgjika, Gjermania e atëhershme perëndimore, Luksemburgu, Franca, Italia dhe Holanda e kanë bashkuarë prodhimin e thëngjillit dhe çelikut dhe e kanë formuar **Bashkimin Evropian** për thëngjill dhe çelik.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Romës në vitin 1957, Bashkësia për thëngjill dhe çelik ngritet në **Bashkësinë evropiane-ekonomike**. Prej atëherë Unioni Evropian zgjerohet me shtete-anëtare të reja.

**Unioni Evropian me formimin e saj mundësoi qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit, ndërsa me marrëveshjen në Shengen edhe qarkullimin e lirë të njerëzve.**



### Viktor Igo

I parë ka shfaqur idenë për bashkimin paqësor të shteteve evropiane, përmes bashkpunimit dhe barazisë të shteteve-anëtare.



- Mësojini emrat e shteteve-anëtare të Unionit Evropian, si edhe të shteteve-kandidate për anëtarësim në Union!
- Në orën e artit figurativ përpunoni aplikacione me flamujt e shteteve-anëtare!
- Përpunoni plakate me shpjegim tabelar!

## Simbolet e Unionit Evropian

Shikoji me kujdes simbolet e Unionit Evropian, dhe hulumto cilat janë karakteristikat e tyre!



**Flamuri i Unionit Evropian**



### Oda e gëzimit

Gëzim i kthjelltë dhe i pastër  
vajzë nga Elizija  
E pijshme je  
si forcë që spërkat  
agoni dhe poezi  
ëndërrat e tua  
prehje dhurojnë  
krimin që e zbut  
gjithë njerëzit i afron  
shpirti yt i bashkon...



**Himni i Unionit Evropian**

**Flamuri** i Unionit Evropian është i përbërë prej dymbëdhjetë yjeve ngjyrë floriri, të renditura në rreth, në prapavijë të kaltërt. Pesë skajet e yjeve simbolizojnë unitetin e popujve të Unionit evropian, ndërsa gjedhja e numrave të yjeve 12, përfaqëson simbolikën e **përsosshmërisë dhe të unitet**.

**Himni** i Unionit Evropian është **Oda e gëzimit**. Kompozitori Ludvig van Betoven e ka kompozuar në vitin 1823, në mungesë të dëgjueshmërisë, ndërsa përfaqëson shprehjen e vizionit për bashkimin e popujve dhe racave në botë.



Të bashkuar në dallime është motoja e Unionit Evropian!

Unioni Evropian nuk është shtet, mirëpo i ka simbolet e saja.

**Flamuri, himni dhe motoja e BE-së, simbolizojnë përkatësi dhe ndjenjë të bashkësisë.**

**EUROJA** është shpallur si valutë nacionale më **1 janar të vitit 2002**, dhe përfaqëson shembull unikat në botë.



Në orën e artit muzikor dëgjojeni himnin e Unionit Evropian!  
Bisedo dhe zbulo simbolikën e tij!

## Insitucionet e Unionit Evropian



Unioni Evropian ka institucione të përbashkëta, të cilat i përfaqësojnë intereset e Unionit, por edhe intereset e vendeve anëtare.

### Institucionet më të rëndësishme të Unionit janë:

**Këshilli i BE-së**, i njohur edhe si Këshilli i Ministrave, është institucion udhëheqës, i cili përfaqëson interesat e të gjitha vendeve anëtare. Ka 27 anëtarë. Detyrat e saja janë buxheti, problemet me kriminalitetin, ligdhënia etj. Selinë e ka në Bruksel.



**Këshilli i BE-së në Bruksel**

Parlamenti i Bashkimit Evropian është organ përfaqësues në BE. Ai ka tre ingerenca të tij: ligdhënëse, kontrolluese dhe buxhetore. Puna e Parlamentit është e hapur çdoherë për qytetarët, të cilët kanë dëshirë ta përcjellin punën, debatet dhe votimet që realizohen. Puna e Parlamentit të Unionit Evropian zhvillohet në dy vende: në Bruksel dhe Strazbur.



**Parlamenti i Unionit Evropian në Bruksel**



**Komisioni Evropian** i përfaqëson dhe i mbbron interesat e bashkësisë. Është e përbërë prej 27 komesariateve. Komisioni është institut i vetëm që mund të propozojë ligje të reja në kornizat e BE-së. Gjatë punës së saj Komisioni është përgjegjës vetëm para Parlamentit Evropian. Përfaqësia gjendet në Buksel.



**Gjyqi Evropian për drejtësi** – ka pushtetin gjykues për aplikimin e ligjeve në BE. I zgjidh ankesat e shteteve fqinje dhe qytetarëve, të drejtat e të cilëve janë të shkelura me ndonjë vendim në organet e Unionit. Gjyqi është i përbërë prej 15 gjykatësve, të cilët ndërrohen çdo 6 vjet. Përfaqësia gjendet në Luksemburg.

Këshilli Evropian nuk është organ, mirëpo luan rol të rëndësishëm. Është i përbërë prej kryetrëve të shteteve anëtare. Qëllim kryesor i këtij këshilli është zhvillimi i BE-së.

Ekzistojnë edhe organe të tjera, komitete këshilldhënëse si dhe një numër të madh agjencish të specializuara.




Ndajuni në grupe dhe përgatitni  
**T-tabelë** sipas drejtimeve!

**Institucionet evropiane:**



**Funkcionet themelore të institucioneve evropiane:**





Cila është ingerenca e Këshillit të Unionit Evropian?

**Integrimi Evropian** i Unionit Evropian është shumë i rëndësishëm. Të gjitha shtetet të cilat dëshirojnë të bëhen anëtarë duhet të kalojnë një proces të gjatë.

**Këshilli Evropian**, si organ vendimmarrës në Union, ka vendosur kriteriume, të cilat vendet candidate duhet t'i plotësojnë për t'u anëtarësuar. Para anëtarësimit vendet candidate duhet të kenë: institucione të cilat garantojnë demokracinë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, aftësi për t'i marrë detyrat të cilat dalin nga anëtarësimi, si dhe aftësia për t'i dhënë mbështetje Unionit për realizimin e qëllimeve të saja.

Me integrimin e vendeve anëtarë të reja rritet dhe demokracia, paqja, stabiliteti, siguria te popujt në Evropë.

Zgjerimi i Unionit Evropian nënkupton hapje të vendeve të reja të punës në vendet e mëparshme dhe të sapoanëtarësuar në Union. Me anëtarësimin në BE qytetarët përfitojnë mundësinë për qarkullim të lirë, të mësojnë dhe punojnë në cilindo vend anëtar tjetër në BE.

Vendi im e fitoi kandidaturën për shtet-anëtar në Unionin Evropian.



## Republika e Maqedonisë dhe integrimi evropian


Njihuni me temën! Lexo tekstin!  
Mësoni nëpërmjet teknikës katrorë!  
Ndahuni në gjashtë grupe!

**Mendoni, bisedoni, bashkëpunoni dhe konsultojuni ndërmjet vete në grupin.** Respektojini mendimin e tjetrit, ndërsa shprehni mendimin tuaj!  
Duhet të jepni sa më shumë argumente për ta arsyetuar mendimin tënd!



**Grupi i parë:**  
(Në përgjithësi)

**Republika e  
Maqedonisë  
Pjesë përbërse e  
BE-së**



**Grupi i gjashtë:**  
(Zbato)

**Çfarë duhet të bëjë  
Maqedonia që të  
bëhet  
shtet-anëtare në BE**

**Grupi i dytë:**  
(Krahaso)

**Hapa të cilat i ka  
bërë  
Maqedonia drejt  
integritimeve**

**Grupi i shtatë:**  
(Diskuto)

**Merr qëndrim për  
argumentet e  
shprehura**



**Grupi i Tretë:**  
(Asoco)

**Integrimi Evropian  
Maqedonia vend-  
kandidat për  
anëtarësim**



**Grupi i katërt:**  
(Analizo)

**Përfitimet nga  
anëtarësimi në BE**

Republika e Maqedonisë morri kandidaturën për anëtarësimin në BE.

**Procesi i integrimit është proces i gjatë dhe i rëndë.** Për t'u afruar deri te vlerat e BE-së, Maqedonia ka dhënë mund të madh për realizimin e shumë reformave.

Republika e Maqedonisë duhet t'i përmbushë edhe disa obligime për t'u bërë anëtare në Union:

- Të vendosë rend dhe paqë në territorin e saj;
- Të mundësojë qeverisjen e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut;
- Të forcojë demokracinë;
- Të mundësojë mbrojtje sociale më të madhë të qytetarëve;
- Të rrisë zhvillimin ekonomik;
- Të zvogëlojë papunësinë;
- Të zvogëlojë ndotjen e ambientit jetësor.




Republika e Maqedonisë me mbështetjen e qytetarëve, hapëron drejt evrointegrimeve.

### MIRËPO MË PARË, ÇFARË DUHET BËRË?

TË PRITET MENDIMI I KOMISIONIT EVROPIAN, që më vonë do të rezultojë me ftesë për anëtarësim.

1. Çfarë bashkësie është Unioni Evropian?
2. Si është krijuar ideja për formimin e BE-së?
3. Kur është themeluar Unioni me këtë emër?
4. Sa shtete e përbëjnë Unionin Evropian?
5. Cilat janë simbolet e Unionit Evropian?
6. Në cilat qytete gjenden institucionet e BE-së?
7. Numëroji institucionet më të rëndësishme?
8. Cilat janë funksionet e tyre themelore?
9. Çfarë ju mundëson Unioni qytetarëve me themelimin e saj?
10. Çfarë statusi gëzon Maqedonia në BE?
11. Cilat kriteriume duhet t'i përmbushë Maqedonija për t'u anëtarësuar në BE?
12. Çfarë do të kishte përfituar Maqedonia nëse bëhet anëtare në BE?



Përpuno shirit kronologjik të Unionit Evropian sipas të dhënave



**1951**-Belgjika, Gjermania e atëhershme perëndimore, Luksemburhu, Franca, Italia dhe Holanda; **1973**- Danimarka, Irlanda, Britania e Madhe; **1981** -Greqia; **1986** - Spanja dhe Portugalia, **1995**-Austria, Finlanda, dhe Suedia; **2004** –Qiproja, Republika Çeke, Hungaria, Estonia, Letonia, Litvania, Malta, Polonia, Sllovakia dhe Sllovenia; **2007**- Bullgaria dhe Rumunia.

## PROBLEMET THEMELORE NË BOTË DHE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË




Sot bota ballafaqohet me probleme, të cilat duhet të zgjidhen në mënyrë globale.

**Globalizimi** është trendi ditor.

Luftërat masovike janë pjesë e historisë botërore.

Sulmet terroriste, rreziqet nga armatimi bërthamor, problemet ekologjike dhe energjetike, lidhjet e komunikacionit global janë gjërat me të cilat ballafaqohet bota.



Mendo dhe bisedo!

Cilat janë rreziqet ndaj paqës në botë?

Shiko fotografi!

Shfrytëzoji revistat, gazetatat, internetin!

Si Republika e Maqedonisë kontribon në ruajtjen e paqës në botë?

**Shkëmbe mendime në klasë!**



Sulmet terroriste shkaktojnë frikë, viktime dhe dëmtime të mëdha materiale. Republika e Maqedonisë e jep kontributin e saj për ruajtjen e paqes botërore, sigurinë luftar kundër terrorizmi me pjesëmarrjen aktive të njësisve ushtarake të ARM-së në forca paqësore.

Veçanërisht duhet të theksohet bashkëpunimi i Republikës së Maqedonisë në suaza të Këshillit partner Evroatlantik dhe Partneriteti për paqe, si edhe bashkëpunimi me NATO-shtetet në përforcimin e sigurisë së përbashkët dhe paqen në botë.

## Problemet ekologjike në botën globale

Lojë: **Reciklojmë për të mbrojtur!**

Ndahuni në grupe! Shënoni, dhe pastaj bisedoni!

**Çfarë hudhet më së shumti në shportën e mbeturinave në shtëpinë tuaj?**



Të mendojmë se si mund të shfrytëzohen kanaqet?

Çfarë mund të bëhet prej plastikës?

Si ta shfrytëzojmë ushqimin që e hedhim?

Si mund të shfrytëzohet letra?



**Tani bëju gati për aksion! Bashkangjitu sipas mënyrës tënde në shpëtimin e planetit?**

Ngrohja e atmosferës së tokës, vrimat e ozonit, tharjet, shkatërimi i pyjeve, ndotja e ajrit dhe ujrave, më mirë i **përshkruan problemet ekologjike të botës globale**. Pa dyshim, ato janë probleme, të cilat duhet të zgjidhen në mënyrë globale. Në botë ekzistojnë edhe mjedise të mbrojtura, mirëpo edhe ato ballafaqohen me probleme ekologjike.

Republika e Maqedonisë si shtetet në botë, është e përqëndruar në mbrojtjen e planetit Tokë. Me vendosjen e ligjit për mbrojtjen e mjedisit jetësor, grumbullimi kolektiv i mbeturinave dhe aksioneve ekologjike, në mënyrë aktive punon në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

**“Mbille ardhmërinë tënde”** është motoja e aksionit më masiv ekologjik që organizohet me rastin e Ditës së drurit në Republikën e Maqedonisë.



**Aktivitetet:**

Vizatoni vepra artistike me temë:

**“ Mbrojtja e mjedisit jetësor”**

Mos harroni të shfrytëzoni materiale natyrore!

**Organizoni ekspozitë!**



## AKTIVITETE EKOLOGJIKE



### Mirë është të dini se:

- » Një shishe plastike ose qese i nevojitet të kalbet 500 vjet
- » Në BE 16% e shumës së ndonjë prodhimi është i determinuar për paketim apo ambalazh, i cili, në shumicën e rasteve, mbaron në mbeturina
- » Shumica e familjeve në nivel vjetor hedhin rreth 40% prodhime plastike, të cilat me sukses mund të reciklohen
- » Xhami mundet tërësisht dhe pakufijshëm me sukses të reciklohet
- » Një shishe e xhamit e recikluar mund të ruajë aq energji, sa i nevojitet një kompjuteri të punojë 25 minuta
- » Me enegjinë të cilën do ta kursejë një konzervë e recikluar, televizioni do të kishte shfrytëzuar të njëjtën 3 orë.
- » 80% e pjesëve të automobilave mund të reciklohen
- » Konzervat e aluminit mund të reciklohen dhe të shfrytëzohen përsëri vetëm 6 javë



**NJERIU NUK ËSHTË PRONAR I PLANETIT, POR VETËM MBROJTËS I SAJ!**

## Energjia – mundësi alternative

Mëso për mundësitë alternative të burimit të energjisë!  
Numëroji mundësitë alternative të burimit të energjisë!  
Si fitohen ato?  
Cilat janë përparësit e tyre në krahasim me burimet tjera?  
Sa shfrytëzohen alternativat burimore të energjisë në Republikën e Maqedonisë?

Shfrytëzoji enciklopeditë, internetin, revistat, dhe burimet tjera të informacioneve.  
Përgatit raport, prezanto dhe krahasoji të dhënat e tua me të tjerët.

### ENERGJIA E MBAN BOTËN!

Njëra nga nevojat më të rëndësishme, padyshim është **energjia**.

Gjatë zhvillimit të botës janë paraqitur **burime të tjera të enegjisë**.



Kërkesa e enegjisë në nivel botëror është në rritje e sipër. Prodhimi i enegjisë, kohëve të fundit, përbëhet prej përdorimit të thëngjillit, naftës, gazit natyral dhe enegjisë nukleare. Në anën tjetër, këto gazra janë ndotësit më të mëdhenj të ambientit jetësor dhe janë arsyeja kryesore për ngrohjen globale. Kjo e vë njeriun në pozitë të mendojë për ndryshimin e prodhimit të enegjisë elektrike, si dhe shfrytëzimin racional të saj.

Bota globale ballafaqohet me problemin e vendosjes së masave për efikasitetin e enegjisë.

Nevojat energjetike të popullatës, zhvillimi ekonomik, zvogëlimi i ndotjes së ambientit jetësor janë arsyet e gjetjes së resurseve dhe alternativave burimore të enegjisë.



Kursimi i enegjisë është rëndësi primare. Me shpenzim të pakontrolluar zhduken të gjitha pasuritë natyrore. Me kursimin e enegjisë, mbrojmë vetveten dhe ambientin.



Resurset e harxhuara të burimeve të parindërtueshme të energjisë kërkojnë zgjidhje për burime të rindërtueshme të energjisë. **Burimet e rindërtueshme** të energjisë janë kudo rreth nesh, ndërsa vlerësohen si më të rëndësishme.



**Energji solare**




**Hidroenergji**



**Energji ajrore**



**Energji gjeotermike**



**Biodizel**

Maqedonia ka potencial të mjaftueshëm për shfrytëzimin e burimeve energjike, siç janë ujërat, dielli, erërat.

Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë aktivitetete për ta kënaqur kërkesën e cila është në rritje, shfrytëzimin dhe kursimin e saj. Në këtë drejtim Agjencioni për energjetikë ka realizuar bashkëpunim ndërkombëtar dhe ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare. Rregullimi i efikasitetit energjik është i përkrahur në Ligjin për energjetikë dhe Strategji nacionale për zhvillim energjik.

**Aktivitetet:** Nëpërmjet teknikës të imagjinatës së orientuar aktivizojeni fantazinë tuaj dhe mendimet shndërroni në fjalë. Paramendoje botën pa energji elektrike. Në orën e gjuhës maqedonase bëni punim me shkrim në temë: **“Tregimi për planetin pa drita”!**



## Bota globale dhe komunikacioni



Përgatit tabelë nocionesh!

### **Karakteristikat e llojeve të komunikacionit!**

Në rreshtat renditi fjalitë, të cilat japin kuptim (komunikacion ajror, internet ..)

Në kolonat vëri karakteristikat sipas të cilave krahasohen llojet e komunikacionit (shpejtësia, siguri etj).

Shfrytëzoji dituritë e mëparshme, të dhënat dhe burimet nga revista, interneti!

Prezentoji dhe krahasoju të dhënat me shokët e klasës!

**Komunikacioni ka qenë dhe është pjesë përbërëse e jetës së njeriut. Sidomos në ditët e sotme, njerëzit në përditshmëri marrin pjesë në komunikacion, sepse ajo është e patjetërsueshme.**

	Shpejtësia	qasja	siguria	ekonomike	e pranueshme
<b>Rrugor</b>			?		
<b>Hekurudhor</b>		?	?	?	
<b>Ujor</b>					?
<b>Ajror</b>			★	★	★
<b>Internet</b>			★	★	★



Me rritjen e lëvizjes njerëzore dhe mallrave, në botë me infrastrukturën e komunikacionit shfaqet edhe nevoja e mbrojtjes së mjedisit jetësor. Problemet në komunikacion dhe transport kërkojnë dituri profesionale për gjetjen e zgjidhjeve për siguri, pranueshmërisë ekologjike.

Sistemi transportues i një vendi është hap drejtë zhvillimit ekonomikë. Republika e Maqedonisë, si pjesë e Evropës dhe botës, investon në zhvillimin e komunikacionit nëpërmjet modernizimit të rrugëve ekzistuese dhe rindërtimin e rrugëve të reja, modernizimin e aeroporteve, edukimin e kadrove profesionale si dhe edukimin e pjesmarrësve të komunikacionit prej moshës më të re.

Zhvillimi i tekonojgisë, posaçërisht në pjesën e këmbimit të informacioneve dhe në komunikacion – internet, luajnë një ndër rolet më të rëndësishme në zhvillimin e botës globale.



Republika e Maqedonisë me përdorimin e tekonojgisë informatike, posaçërisht në modernizimin e shkollimit, ka progres të madh.

Tekonojgia informatike në Republikën e Maqedonisë hap mundësi të reja për zhvillimin efikas të komunikacionit.



ENIAC është kompjuteri i parë. i krijuar në vitin 1945. Ka qenë me përmasa të mëdha, duke zënë një hapësirë të madhe sa një klasë shkollore dhe me peshë prej 30 ton. Për punë dhe bartjen e infomacioneve kanë shfrytëzuar gypa të mëdhenj të cilat shumë shpejtë janë ngrohur, dhe kanë shkaktuar probleme gjatë punës me kompjuterin. Nxehtësia tërheq insekte, që i ka shkaktuar probleme në punë. Në vitin 1980 është prodhuar kompjuteri i parë personal, Koha Kompjuterike filloi.....



## ÇFARË KEMI MËSUAR?




Me ndihmën e teknikës **ditarë me shkrim të dyfishtë**, përsërite atë që mësuam!

Përgatitu! Lexo, mendo, shëno!

Në mes të fletës së zbrazur tërhiq vijë vertikale. Nga ana e majtë shënoji problemet me të cilat ballafaqohet paqa në botë, përballjet energjike, ekologjike dhe problemet e komunikacionit.

Nga ana e djathtë shënoji mendimet e tua, komentimet dhe diçka më tepër, nëse ke hasur gjatë hulumtimit.

Bisedoni, komentoni njohuritë me shokët dhe shoqet e klasës, dhe shkëmbeni edhe vërejtjet e tua!



## FJALORI TERMINOLOGJIK

### A

**Alternativa** – zgjedhje në mes dy mundësive

**Amam** – banjo turke me ngrohje

**An** – flejtore, kafiteri

**Antike** – i referohet kohës së vjetër

### B

**Bashkësi Etnike** – grupe njerëzish ,të cilët i përkasin një populli

### D

**Daton** – preardhje, ka preardhjen nga një kufi kohorë

**Demokracia** – pushtet i popullit, barazi dhe e drejtë e çdo qytetari të marrë pjesë në sjelljen e vendimeve për interes publik dhe shtetëror.

**Deleguar** –i zgjedhur

**Drugdhendës** - Përpunues i drurit.

### E

**Evrointegrime** – bashkimi i popujve evropianë

**Edukim** – arsimim, edukim i të rinjëve

**Endemike** –Bimë ose kafshë, që jetojnë vetë në një territor gjeografik dhe që nuk hasen askund në vend tjetër

**Efikasitet energjetik** – nevojat energjetike përmbushen me prodhimin e sasisë me të vogël

**Etnologjia**- shkencë që e studion lindjen dhe zhvillimin e popujve dhe kulturën e tyre materiale dhe shpirtërore

**Ese** – punim letrar i shkurtër

**Efekt** - rezultat pozitiv

### F

**Folklor**-këngë tradicionale, valle popullore, veshje, doke, tradita, etj.

**Freska**- fotografi, piktura në mur,

**Filigran** – Përpunim i zbukuruar prej tel ari ose argjendi në formë të rrjetës

### G

**Global** – i referohet gjithë planetit tonë, gjithë botës

**Globalizimi** – diçka që mundëson shpërndarje në gjithë botën

### I

**Imagjinacion** – fantazi

**Integrim** – shoqërim, bashkim

**Infrastuktura** – bazë, mbështetës për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, të cilën e përbëjnë linjat e komunikacionit (rrugët, hekurudhët)

**Identifikim** – njohje

**Institut** – ent shoqëror, shkencor ose kulturor

**I kushtëzuar** – i varur

### K

**Komesarë**- pushtetarë përfaqësues për ndonjë sferë përkatëse

**Kooperim** – bashkëpunim për arritjen e qëllimit të përcaktuar

## M

**Mandat** –Kohëzgjatja e një funksioni të caktuar

**Mbipushtet** – kyçje në dy a më shumë qeveri

**Mbinacionale** – politikë e zhvilluar nga më shumë shtete

**Metropol** – kryeqytet i ndonjë shteti

**Migrim** – shpërngulje

**Moral** – përbërje e rregullave të cilat mundësonjë zhvillim harmonik dhe të sukseshëm

**Moralshëm** – i ndershëm

## N

**NATO** – unioni ndërkombëtar ushtarak

**Ndërqeveritar** - Kyçja e dy ose më tepër qeverive

## O

**Ozoni** – mbështjellësi atmosferik, i cili i absorbonë rrezet ultraviolet

**Observatorium**- vend i pajisur për mbikqyrjen e yjeve

## R

**Reciklim** – shfrytëzim në formën origjinale ose formë pak të ndryshuar

## S

**Sankcione** – dënime

**Segment** – pjesë e posaçme e një gjëje të kompletuar

**Status** – gjendje ose pozicion në krahasim me të tjerët

**Specifik**- i përcaktuar, i veçantë

**Stereotipe**- çdo ditë të njëjtat

**Simulime** - aktrim

## T

**Tajfa** – grup

**Terrorizëm** – përdorim i dhunës për t'i figurar të tjerët

**Trauma**- stress për shkak t; ndonjë fatkeqësie

**Thesar**- Pasuri

**Truall** – Tokë ruallemja

## U

**UNESKO** – agjencion në Kombet e Bashkuara e përcaktuar për arsimim, shkencë, kulturë dhe art

## V

**Vrima e ozonit**- pjesë e ozonit, e cila është dëmtuar nga ndotja

# PËRMBAJTJA

## **ATDHEU YNË REPUBLIKA E MAQEDONISË**

<b>ATDHEU YNË REPUBLIKA E MAQEDONISË</b> -----	<b>5</b>
Maqedonia dhe shtetet fqinje -----	8
<b>SIMBOLET SHTETËRORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> -----	<b>10</b>
<b>SHKUPI – KRYEQYTETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> -----	<b>12</b>
<b>VENDPOZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> -----	<b>14</b>
<b>PERIODIZIMI I SË KALUARËS TË MAQEDONISË</b> -----	<b>18</b>
Maqedonia në shekullin e mesëm -----	19
Maqedonia gjatë sundimit otoman -----	20
Luftërat ballkanike dhe Lufta e Parë botërore-----	22
<b>FORMIMI I SHTETIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS</b> -----	<b>23</b>
Maqedonia në Luftën e Dytë botërore -----	23
<b>MËSIM PROJEKTUES</b> -----	<b>26</b>
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR</b> -----	<b>27</b>
<b>RREGULLIMI SHTETËROR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> Kuvendi, Qeveria, Kryetari, Gjuqi -----	<b>29</b>
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR</b> -----	<b>31</b>
<b>POPULLSIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> -----	<b>32</b>
Struktura e popullsisë -----	32
<b>EKONOMIA DHE VEPRIMTARITË EKONOMIKE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË</b> -----	<b>34</b>
Ndikimi i faktorëve natyrorë në zhvillimin e ekonomisë -----	36
Pasuria xeherore-faktor për zhvillimin e ekonomisë -----	37
Relievi dhe zhvillimi i ekonomisë -----	37

<b>TURIZMI NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË -----</b>	<b>38</b>
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR -----</b>	<b>40</b>
<b>JETA KULTURORE DHE INSTITUCIONET KULTURORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË -----</b>	<b>41</b>
<b>RELIGJIONET DHE INSTITUCIONET FETARE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË -----</b>	<b>43</b>
<b>TË DREJTAT DHE DETYRIMET E QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË -----</b>	<b>45</b>
<b>PERSONALITETI NË GRUP DHE NË SHOQËRI</b>	
<b>JETA PERSONALE DHE GRUPORE -----</b>	<b>47</b>
<b>SOCIALIZIMI I PERSONALITETIT NË GRUP -----</b>	<b>50</b>
<b>FAKTORËT E SOCIALIZIMIT</b>	
<b>(familja, grup i moshatarëve, shkolla, mas-mediumet) -----</b>	<b>52</b>
<b>Mas-mediumet si një ndër faktorët për socializimin e personalitetit -----</b>	<b>53</b>
<b>DEVIJIMI DHE SJELLJA DEVIJANTE E PERSONALITETIT NË GRUP -----</b>	<b>57</b>
<b>RREGULLAT E SJELLJES NË MJEDISIN DHE PËRMBUSHJA E OBLIGIMEVE -----</b>	<b>59</b>
<b>KONFLIKTI DHE ZGJIDHJA E TIJ -----</b>	<b>61</b>
<b>TË DREJTAT E FËMIJËVE SI TË DREJTAT E NJERIUT -----</b>	<b>63</b>
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR -----</b>	<b>67</b>



## REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BOTË

<b>TRASHËGIMIA KULTURORE NË TRUALLIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË</b> -----	70
Monumentet e kulturës -----	73
Maqedonia—thesar multikulturor -----	76
<b>DIÇKA E PADETYRUESHME, POR E DOBISHME</b> -----	77
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR</b> -----	78
<b>EMIGRIMI NGA REPUBLIKA E MAQEDONISË NË BOTË</b> -----	79
<b>TË HUAJT NË REPUBLIKË E MAQEDONISË</b> -----	82
<b>PROJEKT MËSIMOR</b> -----	83
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR</b> -----	84
<b>REPUBLIKA E MAQEDONISË DHE INTEGRIMI EVROPIAN</b> -----	85
Çfarë përfaqëson Unioni Evropian? -----	86
Simbolet e Unionit Evropian -----	87
Institucionet e Unionit Evropian -----	88
Republika e Maqedonisë dhe Integrimet Evropiane -----	91
<b>PROBLEMET THEMELORE NË BOTË DHE REPUBLIKA E MAQEDONISË</b> -----	93
Probleme ekologjike në botën globale -----	94
<b>AKTIVITETE EKOLOGJIKE</b> -----	95
Energjia – mundësi alternative -----	96
<b>BOTA GLOBALE DHE KOMUNIKACIONI</b> -----	98
<b>ÇFARË KEMI MËSUAR</b> -----	100
<b>FJALORI TERMINOLOGJIK</b> -----	101
<b>PËRMBAJTJA</b> -----	103